

Çitaku: Pas ngritjes së
aktakuzës për Nagip Krasniqin,
PDK-ja kërkon hetim për
mafinë energjetike I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRFUNDON DËSHMINË NË HAGË ISH-OFCERI I FORCAVE AMERIKANE
NË KFOR, STEVE RUSSELL I FAQE 4

SPEKTAKOLARE, MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-SË DEMOLOI DËSHMITARIN E ZPS-së



Ish-oficeri i NATO-s, Steve Russell, për dytë ditë me radhë në Hagë ka dëshmuar në rastin e liderëve të UÇK-së. Ai në cilësinë e dëshmitarit të ZPS-së është ballafaquar me fakte nga mbrojtja e katërshes së UÇK-së,

veçmas nga ajo e Thaçit. I zënë ngushtë lidhur me dëshminë me shkrim, Russell është lëshuar në interpretime koti dhe bajate, pasi mbrojtja e Hashim Thaçit me zë dhe figurë e ka zënë në rrenë

dëshmitarin e ZPS-së, i cili kishte ofruar dëshmi të paqena nga ato që i kishte thënë Thaçi pas luftës në Gjilan. Dëshmitë e paraqitura nga mbrojtja e Thaçit janë pranuar nga trupi gjyqës

OPINION

FEJTON | GEORGE F. KENAN:
MEMOARE 1925 - 1950 (4)
**ÇFARË U KISHTË THËNË STALINI
PUNËTORËVE AMERIKANË?** F. 9-11

Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ



AKTUALE



**PRESIDENTJA OSMANI RITHEKSON
PËRKUSHTIMIN E KOSOVËS PËR
ANËTARËSIM NË NATO** F. 7

**LDK-ja PREMTON SE DO T'IA
"KËPUSË" RRËNJËT MAFISË
ENERGJETIKE, AAK-JA ZOTOHET
PËR RRIJTJE TË PACËS MINIMALE
NË 1 MIJË EURO** F. 7

**PËR DHJETËRA FËMIJË ME
PROBLEME NË TË FOLUR KUJDESEN
KATËR LOGOPEDË NË OKUK** F. 6

EKONOMI



**39 NDËRMARRJE PËRFITOJNË NGA
DY SKEMAT E GRANTEVE TË REJA
TË MINT-it** F. 8

**BASHKATDHETARËT KËTË VIT
DËRGUAN MË PAK PARA** F. 8

**KURTI:
MARRËDHËNIET
ME SHBA-NË
JANË MË TË
FUQISHME
SE KURRË** F. 5



**ABDIXHIKU:
LDK-ja
ANGAZHOHET PËR
MARRËDHËNIE TË
MIRA ME TË DY
PARTITË E MËDHA
AMERIKANE** F. 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

‘Unë i dhashë zemrën dhe shpirtin këtij kombi’, Bideni fjalim emocionues në Konventën e Partisë Demokratike

ÇIKAGO, 20 GUSHT - Demokratët e drejtuar nga Joe Biden të hënën kanë hapur kongresin e tyre në Çikago. Partia Demokratike është mbledhur mbrëmjen e së hënës për ta dëgjuar fjalën përshëndetëse të presidentit Joe Biden. Bideni ka thënë se zgjedhja e Kamala Harris si zëvendëspresidente në vitin 2020 ishte “vendimi më i mirë që mora gjatë gjithë karrierës sime”. “Si shumë prej jush, unë i dhashë zemrën dhe shpirtin tim këtij kombi”, ka thënë ai, në fund të një fjalimi gati njëorësh të shoqëruar nga thirrjet e zhurmshme “Faleminderit, Joe!”.

Bideni ka dalë në skenë pasi është

prezantuar nga vajza e tij Ashley dhe gruaja e tij, Jill, e cila i ka thënë audiencës se “e pa atë duke gërmuar thellë në shpirtin e tij” kur ai ka vendosur të largohej nga gara presidenciale. Pasi ka përqaftuar Ashleyn, Bideni nuk i ka mbajtur dot lotët. “Ajo do të jetë një presidente tek i cili fëmijët tanë mund të shikojnë. Ajo do të jetë një presidente e respektuar nga liderët botërorë, sepse ajo tashmë është. Ajo do të jetë një presidente me të cilën të gjithë mund të krenohemi. Dhe ajo do të ishte një presidente historike që vendos vulën e saj në të ardhmen e Amerikës”, ka thënë Biden për Kamala Harrisin në



fjalimin e tij. Kalimi i pishtarit prej tij ka demonstruar ndryshimin për

demokratët. Partia, e cila është ndarë thellë muajin e kaluar pasi presioni ishte rritur mbi Bidenin

për të dalë nga gara, është bashkuar të hënën mbrëma pas Harrisit dhe kundër kundërshtarit të saj republikan, ish-presidentit Donald Trump. Demokratët kanë sulmuar kandidatin e GOP-it për të drejtat e abortit. Ata kanë theksuar problemet ligjore të ish-presidentit dhe vunë në dyshim moralin e tij. Dhe ata kanë argumentuar se besimet e tij politike do të përfitonin të pasurit, ndërsa Harrisit do t’u shërbente më mirë njerëzve që punojnë. Partia ka theksuar gjithashtu në terma personale dhe historikë potencialin që Harrisit të bëhet gruaja e parë që fiton presidencën.

Drejtori i CIA-s mbërrin për vizitë në Sarajevë

SARAJEVË, 20 GUSHT - Drejtori i Agjencisë Qendrore të Inteligjencës amerikane (CIA), William Burns, ka mbërritur në Sarajevë të martën për një vizitë, kanë konfirmuar për “Radion Evropa e Lirë” nga qarqet e afërta me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Bosnje e Hercegovinë (BeH).

Burns pritet të mbajë disa takime në Sarajevë, ndër të tjera, me drejtorin e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Bosnje

e Hercegovinës, Almir Xhuvo, si dhe me anëtarët e Presidencës së BeH dhe ministrin e Jashtëm të BeH.

Presidenca dhe Ministria e Jashtme nuk kanë mundur të ndajnë më shumë të dhënat rreth vizitës së Burns.

Një ish-diplomat dhe ish-ambasador në Rusi, Burns është një figurë qendrore në administratën e presidentit amerikan, Joe Biden, pasi ai është gjithashtu anëtar i kabinetit



presidencial të Shtëpisë së Bardhë. Presidenti Biden e kishte emëruar atë në pozicionin e drejtorit të CIA-s në janar 2021.

Burns ishte betuar si drejtor i CIA-s në mars 2021, duke u bërë diplomat i parë në karrierë që shërbeu si drejtor. Presidenti Biden e ka promovuar atë në kabinet në qershor 2023. Ai ka shërbyer gjashtë presidentë dhe administrata (të të dyja palëve) gjatë gati katër dekadave të shërbimit publik në diplomaci dhe inteligjencë. Ai është vetëm diplomat i dytë në histori që u bë zëvendëssekretar i Shtetit. Ai ishte gjithashtu ambasador i ShBA-së në Rusi dhe në Jordani.

Pasi është tërhequr nga shërbimi diplomatik në fund të vitit 2014, Burns ka shërbyer si president i Carnegie Endowment for International Peace. Ai ka diplomuar për histori nga Universitetin LaSalle, dhe ka master dhe doktoraturë për marrëdhënie ndërkombëtare nga Universiteti i Oksfordit.

Ish-drejtori i CIA-s, John Brennan, ishte i fundit nga kjo agjenci që e ka vizituar Sarajevën, pas vizitës së tij më 2016.

Ligjvënësit ukrainas miratojnë ligjin që ndalon grupet fetare të lidhura me Kishën në Rusi

KIEV, 20 GUSHT - Ligjvënësit ukrainas e kanë miratuar më 20 gusht një projektligji që ndalon punën e organizatave fetare të lidhura me Kishën Ortodokse Ruse, të cilën Kievi e sheh si mbështetëse të luftës së nisur prej Moskës në Ukrainë, më 2022.

Deputeti Oleksandr Honcharenko, ka thënë se 25 anëtarë të Parlamentit e kanë miratuar projektligjin, i cili sapo të nënshkruhet nga presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, do të hapë rrugën për ndalim të punës së një dege ukrainase të Kishës Ortodokse, e lidhur me

Patriarkanën e Moskës.

Legjislacioni ndalon aktivitetet e organizatave fetare të lidhura me qendrat e ndikimit “në një shtet që kryen agresion të armatosur kundër Ukrainës”.

Në dokument përmendet se këto aktivitete do të ndalohen edhe me ligj. Projektligji ka qenë çështje e ndjeshme për ligjvënësit.

Në korrik, disa deputetë kanë refuzuar të votojnë për këtë dokument, mirëpo disa të tjerë i kanë bllokuar në sallë, dhe kanë mbajtur në duar mbishkrime, “Kisha e Moskës vret”.

Partia e Zelenskyt, Shërbyesit e



Popullit, është e ndarë lidhur me fatin e legjislacionit që shënjestron Kishën, roli kontrovers i së cilës ka rritur edhe më shumë tensionet, prej nisjes së

luftës. Ligjvënësit ukrainas e kanë miratuar projektligjin në lexim të parë, në tetor të vitit 2023. Dega ukrainase e lidhur me Patriarkanën e Moskës funksionon nën Kishën Ortodokse të Ukrainës, e cila më parë ka qenë nën juridiksion të patriarkut ortodoks rus në Moskë. Mirëpo, Kisha Ortodokse e Ukrainës i ka shkëputur të gjitha lidhjet me Moskën një vit më parë, për shkak të nisjes së luftës, dhe zyrtarët e lidhur me Kishën ruse janë akuzuar se po mbajnë lidhje me Rusinë. Shërbimi ukrainas i Sigurisë ka thënë në tetor se janë

iniciuar 68 raste penale, përfshirë akuza për tradhti, kundër përfaqësuesve të degës së lidhur me Moskën, prej kur ka nisur lufta. Dega ukrainase e lidhur me Kishën e Moskës, ka insistuar që legjislacioni nuk është në përputhje me Kushtetutën e Ukrainës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe e ka akuzuar Kievin që po tenton të portretizojë klerikët dhe besimtarët ukrainas si “agentë të Federatës Ruse”. Kisha Ortodokse Ruse mbështet në masë të madh presidentin rus, Vladimir Putin, dhe luftën e Moskës në Ukrainë.

Çekët do të blejnë municione për Ukrainën me interesin e aseteve të ngrira ruse

PRAGË, 20 GUSHT - Republika Çeke do ta përdorë një pjesë të të hyrave të mbledhura nga interesi i fituar prej aseteve të ngrira ruse në Bashkimin Evropian, për të blerë qindra mijëra predha artilerie për Ukrainën, ka thënë Ministria Çeke e Mbrojtjes, të martën. Shtetet perëndimore kanë bllokuar asete ruse në vlerë të 300 miliardë dollarëve, pas

nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, në shkurt të vitit 2022. Shtetet e BE-së janë duke mbledhur interesin e fituar prej aseteve – ku përfshihen obligacione dhe letra të tjera me vlerë, të blera prej Bankës Qendrore Ruse – dhe po e ndajnë për një fond të bllokut evropian për t’i ndihmuar Ukrainës, teksa lufton pushtimin rus.

Qeveritë e BE-së janë pajtuar në qershor për t’i përdorur 1.4 miliard euro prej interesit të aseteve, për të blerë armë dhe për t’i ndihmuar në forma tjera Ukrainës. Ministria Çeke e Mbrojtjes, Jana Cernochova, ka thënë se disa prej parave mund të shfrytëzohen për të blerë artileri për Ukrainën, me financat e mbledhura nga

partnerët perëndimorë. “Falë të hyrave të siguruar prej financave të ngrira ruse, ne do të mund ta furnizojmë Ukrainën me dhjetëra mijëra fishekë”, ka thënë ministrja Jana Cernochova. Ministria nuk ka dhënë hollësi më shumë, mirëpo ka thënë se pajisjet do të dorëzohen “në muajt vijues”, dhe që do të kenë efekt të shpejtë në



fushëbetejë. Moska nuk i ka komentuar deklaratat e zyrtarëve çekë.

PËRFUNDON DËSHMINË NË HAGË ISH-OFCERI I FORCAVE AMERIKANE NË KFOR, STEVE RUSSELL

Spektakolare, mbrojtja e liderëve të UÇK-së demoloi dëshmitarin e ZPS-së

Ish-oficeri i NATO-s, Steve Russell, për dytë ditë me radhë në Hagë ka dëshmuar në rastin e liderëve të UÇK-së. Ai në cilësinë e dëshmitarit të ZPS-së është ballafaquar me fakte nga mbrojtja e katërshes së UÇK-së, veçmas nga ajo e Thaçit. I zënë ngushtë lidhur me dëshminë me shkrim, Russell është lëshuar në interpretime koti dhe bajate, pasi mbrojtja e Hashim Thaçit me zë dhe figurë e ka zënë në rrenë dëshmitarin e ZPS-së, i cili kishte ofruar dëshmi të paqena nga ato që i kishte thënë Thaçi pas luftës në Gjilan. Dëshmitë e paraqitura nga mbrojtja e Thaçit janë pranuar nga trupi gjykues

EPOKA
ERE

Lirim GECI

HAGË, 20 GUSHT - Ish-oficeri i forcave amerikane në KFOR, Steve Russell, ka përfunduar dëshminë e tij në procesin gjyqësor kundër liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Për dy ditë sa ka zgjatur dëshmia e tij, ai ka qenë i shoqëruar nga tre zyrtarë të qeverisë amerikane. Mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka sfiduar qëndrimet e tij për UÇK-në dhe NATO-n, pasi në dëshminë e tij me shkrim para Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) kishte dhënë deklarata të çuditshme për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë. Fillimisht, një performancë të jashtëzakonshme faktesh ka paraqitur mbrojtja e ish-presidentit Hashim Thaçi. Russell në intervistat e tij kishte folur për zhvillimet në rajonin e Gjilanit, kryesisht pas qershorit 1999. Russell kishte thënë në intervistat e tij të mëhershme për prokurorinë se Thaçi kishte deklaruar gjatë një vizite në Gjilan, menjëherë pas luftës, se ishte për një Kosovë jomultietnike.

Mbrojtja e ka sfiduar dëshmitarin me videon e fjalimit nga ajo ngjarje ku, në fakt, Thaçi nuk e kishte thënë fare atë gjë, madje kishte folur të kundërtën, që të mos ketë krime dhe as ndasi etnike. “Besoj se e dëgjuat tani fjalimin?! Hashim Thaçi nuk ka thënë atë çfarë pretendoni ju se ka thënë ai. Ju keni thënë që ai ka thënë se nuk dëshironte që të kishte një Kosovë multietnike, apo jo?”, ka pyetur avokatja e Thaçit.

I zënë ngushtë, dëshmitari Russell është përpjekur të nxirrej në disa emra qytetesh dhe interpretimesh. “Jo saktësisht e formuluar kështu, ndoshta, por mendoj që pjesa e lidhur me Mitrovicën që e dëgjova unë, mund të interpretohet në atë mënyrë, më pas komentet për Luginën e Preshevës që ata duhet të ishin të lirë që të vetëvendosnin, besoj se do të më çonin mua të bëj të njëjtat

momente që kam bërë edhe më përpara sa iu takon këtyre pjesëve, këtyre zonave”, është përgjigjur dëshmitari Russell.

Më pas, avokatja ia ka kthyer dëshmitarit se, në fakt, Thaçi, kur ka folur për Mitrovicën, ka folur për bashkim, për urën që i bashkon njerëzit dhe qytetet e jo për dëbime. “Nuk jam e qartë me atë çfarë thatë lidhur me Mitrovicën. Besoj është nga fundi i faqes pesë ajo çfarë ka thënë në transkript, që ka një ndarje de-fakto të qytetit atje, një ndarje që na shqetëson, kështu që ne po bëjmë më të mirën tonë të ndërpresim këtë ndarje në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar, ka pasur një urë, ura e Ibrit, dhe ne do të punojmë që kjo të jetë urë lidhëse, një urë që i bashkon qytetet. A është kjo pjesa që ju thoni se ai nuk po shfaqte, nuk po parashikonte një Kosovë multietnike? Me këtë e lidhni komentin tuaj?”, ka vazhduar pyetjet avokatja e Thaçit.

Dëshmitari Russell është përgjigjur se kështu e kishte interpretuar ai. “Mendoj se të paktën mënyra se si e kemi kuptuar ne, ekzistonte pjesa e serbëve në Mitrovicë dhe duhej që të zgjidhej, le të themi, dallimi ose ndarja që ekzistonte atje pavarësisht se si mund të interpretohet kjo”, ka thënë Russell.

Avokatja më pas i ka kërkuar një fakt mbi atë interpretim që po bënte. “Sa i takon analizës historike që ju mendoni se është e saktë, ju thoni si më poshtë: ‘fjalimi i Thaçit ishte armiqësor dhe ishte kundër multietnicitetit’. A mund të na thoni për çfarë e keni fjalën? A mund të na thoni një fakt se nga e keni nxjerrë këtë përfundim tuajin sa i takon këtij fjalimi të zotit Thaçi?”, ka pyetur ajo.

Më tutje, avokatja ka shtruar pjesë nga deklarata e mëparshme e Russellit në prokurori, duke e cituar se e kishte thënë disa herë se Thaçi fliste për një Kosovë pa multietnicitet.

Kur nga kjo është zënë më shumë ngushtë, dëshmitari ka tentuar të dalë te Lugina e Preshevës, që Thaçi e kishte



përmendur në fjalim. “Ai foli për Luginën e Preshevës dhe në ato rajone që duhej të vendosnin vetë për të ardhmen e tyre dhe kjo ishte në kundërshtim me Rezolutën 12 44”, ishte përgjigja e tij.

Por avokatja sërish insistoi në fakte. “Do të flasim për Preshevën pak më vonë. Megjithatë, pyetja ime ishte kjo: Nuk ka thënë zoti Thaçi në asnjë vend ato që pretendoni që ka thënë, apo jo?”, ka pyetur avokatja e Thaçit, Por Russell sërish ka tentuar të nxirrej nga “bataku” me interpretime. “Interpretimi i Mitrovicës, mënyra se si interpretoj unë, pjesa e lidhur me Mitrovicën, ishte që ai ka folur për problemet ose shqetësimet që kanë qenë aty, ose të paktën interpretimi im është që serbët nuk ishin të mirëpritur. Sa i takon kontekstit më të gjerë, mendoj që mund të interpretohet fjalimi, ose pjesa e fjalimit që serbët nuk ishin të mirëpritur në Kosovë”, ka thënë ai.

Pas kësaj “përgjigjeje”, debati ka kaluar në atë se dikush tjetër atë ditë që ka folur pas Hashim Thaçit, ka përmendur një Kosovë pa serbë. Avokatja i ka thënë dëshmitarit Russell se i ka të gjitha fjalimet e asaj dite në Gjilan dhe se mund t’i lëshonte. “Unë kam videot e të gjitha fjalimeve që janë mbajtur atë ditë dhe unë ju parashatroj se asnjë folës atë ditë nuk ka folur lidhur me nevojën për të pasur një Kosovë pa serbë dhe nëse doni, mund ta transmetoj të gjithë videon?”, ka thënë

avokatja.

Nga trupi gjykues është mundësuar të lexohen transkriptimet e fjalimeve të asaj dite. Dhe derisa kalonte nëpër faqe, Russell nuk e gjente askund që dikush kishte thënë se “na duhet një Kosovë pa serbë”.

I zënë ngushtë, dëshmitari ka tentuar të kapej në mundësinë që videot të ishin të redaktuara. “Nga këto fragmente nuk shikoj asnjë deklaratë të tillë me videon duke menduar që çdo gjë ka qenë në vijimësi e pandryshuar, e paedituar, e paredaktuar...”, ka thënë Russell.

Kurse avokatja e Thaçit ka thënë se ky përkthim dhe transkriptim është pasqyrë e plotë e asaj çfarë është thënë në fjalime dhe se ato janë dhënë nga transmetuesi i asaj kohe.

Mbrojtja e Thaçit ka thënë se as mediet e tjera, si “Associated Press”, por edhe ato vendore, nuk kishin raportuar për një deklaratë të tillë nga Thaçi apo dikush tjetër. Dhe shkrimet nga këto medie janë prezantuar në sallë dhe edhe video nga fjalimi i Hashim Thaçit është pranuar si prova nga trupi gjykues.

Gjatë seancës avokatja e Thaçit ka publikuar një raport të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), ku ka theksuar qartë që Hashim Thaçi ka dënuar sulmet ndaj civilëve serbë si dhe ka dënuar sulmin ndaj serbëve në Grackë të Lipjanit.

Ky dëshmitar ishte kontrovers edhe në pika të tjera, pasi mbrojtja e ka sfiduar me qëndrimet e tij se “fushata ajrore

e NATO-s kundër Serbisë nuk ishte për qëllime të paqes”.

Në ditën e dytë të dëshmisë, dëshmitari Russell ka tentuar t’u shmangej pyetjeve të avokatëve të tjerë të liderëve të UÇK-së. Avokati i Rexhep Selimit, Eric Tully, ka insistuar në pyetjet për dëshmitarin e ZPS-së lidhur me kartat identifikuese të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe nëse kanë pasur kontakt me Ministrinë e Rendit Publik. Derisa avokati i Selimit insistonte në pyetjen e tij, në një moment dëshmitari Russell ka thënë: Ju po bëni një pyetje shumë të vështirë dhe doni një përgjigje të thjeshtë.

Më tutje, avokati Tully ka kërkuar ta dijë nëse Russell kishte kontaktuar ndonjëherë ministrinë e atëhershme për t’i pyetur ata nëse kishin lëshuar kartela identifikimi.

Kurse avokati i Jakup Krasniqit, Aiden Ellis, e ka pyetur dëshmitarin Russell lidhur me bastisjen nga KFOR-i në një fjetore dhe nëse ka parë dokumente të nënshkruara nga Ahmeti Isufi. Dëshmitari Steven Russell ka thënë se ka qenë i pranishëm në këtë bastisje dhe e ka parë dokumentin, i cili i është dhënë nga Florim Klllokoqi.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në Qendrën e Paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar më 3 prill të vitit 2023. Ata janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat që ngarkohen nga Gjykata Speciale.

FLET KRYEMINISTRI ALBIN KURTI

Marrëdhëniet me ShBA-në janë më të fuqishme se kurrë

- Nuk do t'i befasojmë aleatët, por hapja e urës së Ibrit nuk do të zvarritet pafundësisht

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se për hapjen e urës së Ibrit nuk do t'i befasojnë aleatët ndërkombëtarë. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë për "Zërin e Amerikës" se hapja e urës nuk do të zvarritet pafundësisht. Sa iu përket kritikave të ShBA-së për çështjen e urës, Kurti ka thënë se marrëdhëniet që është duke ndërtuar me Amerikën janë më të fuqishme se kurrë. "Nuk besoj që ka kurrfarë dëmtimi të marrëdhënieve. Është e vërtetë që unë nuk ngjasoj me kryeministrat që kanë qenë në Republikën e Kosovës para meje, por unë besoj që marrëdhëniet që po ndërtoj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë më të fuqishme se kurrë", ka thënë Kurti



ÇIKAGO, 20 GUSHT - Kryeministri i Kosovës Albin Kurti, ka thënë për "Zërin e Amerikës" se hapja e urës mbi lumin Ibër për qarkullim të automjeteve do të bëhet bazuar në një plan të cilin qeveria e tij, sikurse ka theksuar ai, e ka ndarë me partnerët amerikanë dhe evropianë. Ai ka thënë se Prishtina ka zhvilluar konsultime me komunitetin serb në veri dhe në jug të Kosovës, si dhe ka testuar qëndrueshmërinë fizike e teknike të urës mbi Ibër. Ai ka thënë se në raport me këtë çështje, Kosova synon që në njërin anë të mos i befasojë partnerët por, në anën tjetër, të mos lejojë që kjo çështje të zvarritet pafundësisht. Kurti ka folur edhe mbi përplasjet me Perëndimin si dhe kritikën e opozitës për mungesë bashkërendimi me aleatët për shumë çështje. Por, sipas kryeministrit të Kosovës, dallimet në qëndrime nuk kanë qenë asnjëherë në qëllime, vlera e parimeve, por vetëm në strategji, taktika dhe operacione.

Zoti Kurti, duke filluar nga sot për 4 ditë, demokratët do të mbledhen në atë që zakonisht është një paradë festive e partisë. Por krahas zhvillimeve normale në kuadër të punimeve të Kuvendit, zakonisht aktivitete të tilla shoqërohen edhe me takime të tjera jashtë sallës. Cili është synimi juaj gjatë këtyre ditëve në Çikago?

Albin Kurti: Ky Kuvend Kombëtar i Demokratëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është historik. Në njërin anë kemi rrethana të papara e të papërfjetuara edhe për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa në anën tjetër kemi edhe një entuziazëm të jashtëzakonshëm dhe një vitalitet të demokracisë, i cili është unik për mbarë botën. Në këtë Kuvend Kombëtar të demokratëve do të kem

mundësinë të zhvillojë edhe disa takime të rëndësishme, por duhet theksuar se këtu jam ftuar si Kryeministër i një shteti demokratik dhe si kryetar i një subjekti politik socialdemokrat. Sidomos në vitet e fundit, Kosova ka shënuar një zhvillim të hovshëm ekonomik me 6.2 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto si rritje mesatare ekonomike, por edhe një progres të shquar demokratik, meqenëse edhe sa i përket sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit, lirisë së medie, të drejtave politike dhe lirive civile, Kosova është kampione në Ballkanin Perëndimor. Prandaj, ne kemi çfarë t'u tregojmë miqve dhe partnerëve tanë amerikanë për sukseset e Kosovës dhe njëkohësisht të mësojmë nga përvojat e tyre, që janë të paçmueshme.

Megjithatë, zoti kryeministër, ditët e fundit ju jeni përplasur sërish me Perëndimin lidhur me vendimin tuaj për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë për trafikun e makinave. Të gjithë diplomatët e akredituar në Kosovë dhe zyrtarët e forcave paqeruajtëse kërkojnë që ju të mos e bëni këtë gjë tani. A keni ndryshuar qëndrim rreth kësaj çështjeje?

Albin Kurti: Me partnerët tanë evropianë dhe amerikanë ne asnjëherë, në asnjë situatë, nuk kemi dallime sa i përket qëllimeve, vlerave dhe parimeve. Nganjëherë rrallë, kemi dallime sa i përket strategjive, taktikave dhe operacioneve. Por, zakonisht këto dallime të jashtëzakonshme, sepse janë të rralla, bëhen lajme të mëdha. Ndërkaq përputhshmëria e zakonshme është ajo që nuk arrin të bëhet lajm. Edhe në këtë rast, kemi një situatë të ngjashme, ura mbi lumin Ibër është dashur të hapej atëherë kur është çliruar Kosova para 25 viteve. Ajo nuk është

dashur të jetë e mbyllur atëherë kur u pavarësua Kosova para 16 viteve. Ajo është dashur të jetë e hapur edhe para tetë viteve, në bazë të marrëveshjes së Brukselit dhe planit të zbatimit. Në këtë mënyrë, në jemi trefish të vonuar për shumë vite dhe ajo çfarë duam të bëjmë është veçse lëvizje e lirë për të gjithë qytetarët, mallrat dhe kapitalin. Në të dyja anët e lumit Ibër të ketë sundim të ligjit, që nuk e përjashton askënd dhe kjo paraqet vetë frymëmarrjen e shtetit demokratik. Duhet të na mirëkuptoni që ne mund të themi që sundimi i ligjit dhe lëvizja e lirë vlejnë gjithandëj Kosovë, për të gjithë, tërë kohën, përveçse në urën kryesore mbi lumin Ibër. Jemi duke i dëgjuar me vëmendje të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet. Kurrë nuk ka pasur më shumë konsultime dhe koordinim dhe jam optimist se do ta kemi edhe sundimin e ligjit dhe lirinë e lëvizjes në njërin anë, edhe paqen, sigurinë dhe qetësinë në anën tjetër. Hapja e urës mbi lumin Ibër në Mitrovicë nuk është kundër askujt. Ajo është për komunitetin serb, për shqiptarët, për boshnjakët dhe për të gjitha pakicat e tjera, si turqit, egjiptianët, ashkalinjtë dhe romët. Kjo është për të gjithë qytetarët e republikës tonë demokratike. Evropa i ka shembur të gjitha muret. Ne jemi në Evropë dhe duhet ta hapim edhe këtë urë.

Zoti kryeministër, kur thoni se po dëgjoni sugjerimet, a do të thotë që mund edhe ta shtyni në kohë vendimin?

Albin Kurti: Ne jemi të interesuar që hapjen e urës ta bëjmë në bazë të planit, të cilin e kemi ndarë së bashku me partnerët, miqtë, aleatët amerikanë dhe evropianë. Kemi zhvilluar konsultime me komunitetin serb në veri të Kosovës dhe në jug. Konsultime janë bërë edhe me shqiptarët, edhe me komunën veriore dhe jugore të

Mitrovicës. Gjithashtu kemi testuar qëndrueshmërinë fizike dhe teknike të urës mbi Ibër dhe po bëjmë një dizajnim, zbulim, sepse duhet të kujdesemi edhe për pamjen vizuale të kësaj ure. Duam që ta bëjmë sa më parë. Por as nuk do t'i befasojmë partnerët, miqtë dhe aleatët tanë evropianë dhe amerikanë në njërin anë, por në anën tjetër, as nuk do të mund të lejojmë që kjo çështje të zvarritet pafundësisht. Vullnetin dhe qëllimin e kemi të mirë dhe besojmë se hapja e kësaj ure është e drejtë, e nevojshme, e mirë dhe e dobishme për të gjithë.

Zoti kryeministër, opozita tek ju është e pakënaqur, kërkon që veprimet në veri të jenë të bashkërenduara me aleatët, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara dhe ju kritikon se situata si kjo me urën po shfrytëzohet për qëllime elektorale. Si u përgjigjeni këtyre kritikave?

Albin Kurti: Unë kisha shpresuar që do të kishim zgjedhje në muajin qershor, ose korrik. Pastaj kisha shpresuar që do të kishim zgjedhje në vjeshtë të këtij viti, mirëpo duke qenë që zgjedhjet do të jenë me 9 shkurt të vitit të ardhshëm, nuk mund të thuhet që kjo ka të bëjë me fushatën elektorale. Përkundrazi, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, që unë drejtoj, është shumë komod drejt zgjedhjeve të reja. Mbështetja për ne është edhe më e madhe tani, sesa në pranverën e vitit 2021. Ajo çfarë ne po bëjmë është sundimi i ligjit në një shtet sovran, demokratik e të pavarur për të mirën e të gjitha komuniteteve pa dallim. Lëvizja e lirë është diçka që nuk mund të negociohet për shkak se është e drejtë themelore, por në të njëjtën kohë, unë i kuptoj partnerët tanë, të cilët shfaqin brenga sa i përket cenimit të sigurisë dhe me planin tonë ne po i minimizojmë të

gjitha frikërat, ose perceptimet e frikës, që ekzistojnë tek kushdo në këtë periudhë. Pra edhe për të mirën e opozitës, ne besojmë që është mirë që bashkërisht ta realizojmë këtë hapje të urës meqenëse marrëveshja për hapjen e urës është bërë në Bruksel pikërisht nga ata që dikur ishin qeveri, e sot janë në opozitë.

Zoti kryeministër, Bashkimi Evropian thotë se kjo çështje duhet të diskutohet në Bruksel me Serbinë, megjithëse ka rënë dakord se është diskutuar dhe më herët. A jeni të gatshëm ta ridiskutoni këtë çështje në Bruksel?

Albin Kurti: Diskutimet në Bruksel janë zhvilluar në vitet 2014-2017 dhe ato kanë përfunduar jo vetëm me marrëveshje për hapjen e urës, por njëkohësisht edhe me marrëveshje për një plan të zbatimit se si do të duhej të hapej ura. Afati i fundit ka qenë 20 janari i vitit 2017. Nëse është bërë një marrëveshje dhe bëhet diskutim mbi marrëveshjen kjo është një mënyrë indirekte e shkeljes së marrëveshjes. Ne nuk jemi të gatshëm që të marrim pjesë në shkelje të marrëveshjes dhe liria e lëvizjes mbi lumin Ibër, në urën kryesore në Mitrovicë, nuk do të duhej që të rinegociohej. Ura është tejkallim, është tejkallim i lumit. Nuk mund të kemi tejkallim të urës, sepse shpeshherë ka pasur sugjerime që mjaftojnë urat e tjera. Nuk mund t'i bëjmë urën, urës. Ura ia bën urën lumit Ibër për të mirën e qytetarëve dhe për këtë insistojmë ne.

Zoti kryeministër, ka kaluar një vit e gjysmë që nga momenti që ju keni rënë dakord në Bruksel dhe në Ohër për një marrëveshje normalizimi, por pothuajse asnjë hap nuk është hedhur drejt zbatimit të saj. Nëse ju nuk filloni zbatimin e marrëveshjes për themelimin e Asociacionit dhe

Abdixhiku: LDK-ja angazhohet për marrëdhënie të mira me të dy partitë e mëdha amerikane

PRISHTINË, 20 GUSHT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se ka pranuar ftesë nga NDI-ja për të marrë pjesë në Konventën e Demokratëve në Çikago, por që në vend të tij e ka dërguar Alush Gashin. Ai ka thënë se Gashi do të qëndrojë për katër ditë atje,

duke shtuar se LDK-ja angazhohet për marrëdhënie të mira me dy partitë amerikane. “I nderuar me ftesën e NDI-së për pjesëmarrje në Konventën e Demokratëve në Çikago. Në këtë konventë kam deleguar profesorin e nderuar Alush Gashin, bashkëpunëtorin e ngushtë e anëtarin e Kryesisë

Qendrore të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Profesor Gashi, do të qëndrojë për katër ditë e punimeve të Konventës. Aty pritet konfirmimi i kandidaturës për Presidente nga radhët e demokratëve, nënkryetares së tanishme Kamala Harris. LDK-ja angazhohet për marrëdhënie

të mira me të dy partitë e mëdha amerikane, si faktor e kontributdhënës historik në kauzën tonë për liri, pavarësi e demokraci. Mbi të gjitha, me rrugëtimin e ngushtë me aleatët tanë identitar, ShBA-të, drejt realizimit të qëllimeve tona kombëtare!”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.



Osmani: Së pari vlerësime të përbashkëta për sigurinë, pastaj data për hapjen e urës

PRISHTINË, 20 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se hapja e urës së Ibrit në Mitrovicë duhet të bëhet në bazë të një plani me partnerët ndërkombëtarë. “Duhet, siç e parasheh edhe vetë plani i zbatimit të marrëveshjes së arritur në gushtin e vitit 2016, të kemi vlerësime të përbashkëta të sigurisë me partnerët tanë, pas atyre vlerësimeve dhe planit të përbashkët, ajo do të përcaktojë pastaj datën”, ka thënë presidentja Osmani për “Radion Evropa e Lirë”. Rihapja e urës për qarkullim edhe të automjeteve, e cila ndan Mitrovicën në jug me shumicë shqiptare dhe në veri me shumicë serbe, është kundërshtuar nga bashkësia ndërkombëtare dhe nga serbët lokalë. Ushtarët italianë të KFOR-it ndodhen në urën mbi lumin Ibër, ndërsa pjesëtarët e Policisë së Kosovës ndodhen afër saj. Vendet e Quint-it, ShBA-ja, Britania, Franca, Gjermania dhe Italia, e kanë

quajtur të njëanshëm synimin e qeverisë së Albin Kurtit për rihapjen në këtë kohë. Bashkimi Evropian ka bërë thirrje që çështja e urës të diskutohet në dialog me Serbinë. Presidentja Osmani ka thënë se “ura mbi lumin Ibër duhet të hapet dhe hapja e saj është vonuar për tetë vjet me radhë”. “Çdoherë kur Kosova, në historinë e saj, ka bashkëpunuar me partnerët, çdoherë ka pasur sukses”, ka thënë Osmani. Ajo ka thënë se lidhur me këtë çështje ka folur me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, para një muaji. Sipas Osmanit, rihapja e temës së urës në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është e rrezikshme. “Kjo çështje ka përfunduar sa i përket dialogut me Serbinë, por duhet të ketë koordinim me partnerët tanë ndërkombëtarë, në veçanti me NATO-n”, ka thënë Osmani. Presidentja ka theksuar se koordinimi brenda Kosovës me



aleatët do të ndikonte edhe në rrafshin ndërkombëtar dhe do ta rriste besimin dhe entuziazmin për ta ndihmuar Kosovën edhe në rrafshin e njohjeve të reja dhe të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. Lidhur me veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri, Osmani ka thënë se ato gjatë dy viteve të fundit janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, por ka theksuar se ndonjëherë ka nevojë për më shumë hapësirë që të diskutohet

me qytetarët që të kuptohet qëllimi. Osmani i ka vlerësuar të tmerrshme për qytetarët në veri ato që ajo i ka quajtur ndërhyrje ilegale dhe kriminale në veri të Kosovës nga Vuçiqi. Presidentja ka deklaruar se nuk mund të ketë integrim të qytetarëve serbë në veri, derisa ata, sipas saj, janë nën presion të bandave kriminale. Sa i përket dërgimit të draft-statutit të Bashkimit Evropian për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, Osmani ka thënë se nuk ka hezitim, por se ai ekziston te zbatimi i njëanshëm i Marrëveshjes bazë ku, sipas saj, Serbia ka hequr dorë nga marrëveshja. Osmani ka thënë se është duke diskutuar me aleatët ndërkombëtarë që Kosovës t'i ofrohen garanci të sigurisë dhe anëtarësim në organizata

ndërkombëtare nëse nga Kosova kërkohet ta zbatojë Marrëveshjen e Ohrit. Për bashkëpunimi me Qeverinë e Kosovës, Osmani ka thënë se bashkëpunon me të për çështje të interesit nacional, për interesin e qytetarëve. Ndër të tjera, Osmani ka folur edhe për atë se a do të kërkojë edhe një mandat si presidente e Kosovës. Presidentja Osmani ka thënë se shpreson që institucionet e drejtësisë do ta hetojnë në hollësi rastin e vrasjes së një familjari të bashkëshortit të saj më 16 gusht në Ferizaj, ndërsa mohoi çfarëdo pretendimi se ajo ka qenë në dijeni rreth rastit. “E vetmja çështje për të cilën unë kam reaguar ka qenë implikimi i rrejshëm, komplet i rrejshëm dhe i rrezikshëm i emrit tim për çështje për të cilat nuk kemi as njohuri, as ndonjë relevancë, as ndonjë lidhje kurrë dhe as tash”, ka thënë Osmani.

Serbia refuzon t'i përmbushë detyrimet që çojnë në njohjen de facto të Kosovës, mund të krijohet një status quo, apo një lloj konflikti i ngjirë. A keni ju një plan B për ta tejkaluar situatën?

Albin Kurti: Nuk mund të kemi plan B nëse nuk respektohet plani A dhe nëse nuk ka vullnet të mirë dhe mirëbesim të palëve. Është e vërtetë që ka kaluar një vit e gjysmë që kur ne kemi bërë marrëveshjen në Bruksel, marrëveshja bazike, së cilës iu bashkëngjiti edhe aneksi i zbatimit, nga Ohri. Ne e respektojmë marrëveshjen, ne jemi të gatshëm që ajo të zbatohet, por nuk mund të kemi partneritet në zbatim, përderisa ka mosrespektim. Në dhjetor të vitit të kaluar ish-kryeministrja e Serbisë Bërnabiq, praktikisht me letër publike dhe zyrtar drejtuar 27-es së Bashkimit Evropian, u tërhoq në emër të Serbisë nga marrëveshja bazike. Pra Serbia duhet të kthehet tek marrëveshja, ta respektojë atë, në mënyrë që ta zbatojmë. Në

kuadër të kësaj marrëveshjeje janë edhe 39 marrëveshjet e mëhershme që pararendësit e mi i kanë bërë në Bruksel. Unë jam shumë i interesuar përveçse i gatshëm, që t'i trajtoj ato me përpikëri dhe përkushtim, në mënyrë që të normalizohen marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë të cilat natyrisht në zemër të tyre duhet të kenë atë që siç e ka quajtur presidenti amerikan Biden, njohje reciproke, pra ku Kosova e njeh Serbinë sepse Serbia e njeh Kosovën.

Zoti kryeministër, ju ndodheni në Çikago në kuadër të njëjës prej vizitave të rralla në Shtetet e Bashkuara dhe, sipas kritikëve, kjo pasqyron një rënie të nivelit të marrëdhënieve të Kosovës me aleatët kryesorë të saj. A jeni i shqetësuar se këto marrëdhënie janë dëmtuar seriozisht?

Albin Kurti: Nuk besoj që ka kurrfarë dëmtimi të marrëdhënieve. Është e vërtetë që

unë nuk ngjasoj me kryeministrat që kanë qenë në Republikën e Kosovës para meje, por unë besoj që marrëdhëniet që po ndërtoj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë më të fuqishme se kurrë. Ne kemi bërë kontratën më të madhe që është bërë ndonjëherë me Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit, 236 milionë dollarë, për bateritë për energjinë e ripërtëritshme, dhe përveç kësaj jemi duke blerë sistemet antitank Javelin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse dëshirojmë që të forcojmë ushtrinë tonë. Forca e Sigurisë së Kosovës ka bashkë-zbarkuar me ushtrinë amerikane në Kuvajt dhe në çdo aspekt, në tregti, në energji, në ekonomi, dhe pastaj bashkëpunimi jonë me USAID-in e solli vlerësimin e Kosovës me 2B minus, që është vlerësimi i parë nga Fitch Ratings, i një organizate ndërkombëtare për ekonominë tonë, në arenën ndërkombëtare ekonomike. Bashkëpunimi me ShBA-të është zgjeruar dhe është

thelluar, mospatimet sporadike, kurrë për vlera parime e qëllime, po nganjëherë, për strategji taktika dhe operacione, bëhen lajme të mëdha. Unë besoj që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë shumë arsye që të jenë krenare me arritjet e Kosovës, më shumë se asnjëherë më parë, e për zhvillimin e ndërtimin e së cilës, kanë kontribuar si askush tjetër.

Zoti kryeministër, në pak muaj në Shtetet e Bashkuara mbahen zgjedhjet presidenciale, të cilat po ndiqen me vëmendje në të gjithë botën. Një pjesë e udhëheqësve të NATO-s kanë shprehur shqetësimin e tyre në rast të ndryshimit të administratave, duke pasur parasysh qëndrimet e zotit Donald Trump ndaj NATO-s. A jeni të shqetësuar ju në këtë aspekt, duke pasur parasysh marrëdhëniet tuaja me ish-administratën Trump?

Albin Kurti: Padyshim që kemi një situatë në të cilën Partia Republikane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka një

kandidat të pazakonshëm, bëhet fjala pra për ish-Presidentin Donald Trump, i cili në raport me NATO-n ka patur si vërejtje të tij kryesore, që shtetet anëtare do të duhet që të arrijnë kuotën prej 2 për qind sa i përket shpenzimeve për mbrojtjen dhe sigurinë. Në këtë aspekt besoj që Kosova është në anën e ndritshme, për shkak se ne tashmë e kemi mbërritur kuotën prej 2 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto, meqenëse i kemi dyfishuar shpenzimet për mbrojtjen, e kemi trefishuar shpenzimet për armatime, si dhe i kemi katërfishuar trajnimet jashtë vendit, për ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ne, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i shohim si partner dhe në preokupimin kryesor të ish-presidentit Trump, Kosova edhe aty merr notë pozitive. Natyrisht kjo nuk e ndryshon faktin që unë si kryetar subjekti politik dhe si Kryeministër i Republikës së Kosovës, mbetem demokrat, mbetem socialdemokrat.

“Kurti në përkrahje të Harrisit”, Grenelli: Një lëvizje e pamatur nga ana e Kurtit, kjo dëmton popullin e Kosovës

UASHINGTON, 20 GUSHT - Richard Grenell, diplomat që ka shërbyer përfaqësues i posaçëm i Shteteve të Bashkuara (ShBA) për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë gjatë mandatit të parë të presidentit amerikan Donald Trump, ka kritikuar

pjesëmarrjen e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në Konventën Kombëtare të Partisë Demokratike në Çikago të ShBA-së. Grenelli në platformën “X” ka paralajmëruar pasoja për popullin e Kosovës, posaçërisht sa i përket

mbështetjes së hapur të kreut të ekzekutivit të Kosovës për nënpresidenten aktuale amerikane Kamala Harris, njëherësh e nominuar e demokratëve në garën presidenciale të nëntorit kundër ish-presidentit Trump. “Që lideri i Kosovës të zgjedhë

hapur demokratët është një lëvizje e pamatur nga ana e Kurtit... Përveç ndërhyrjes në zgjedhjet amerikane, mbështetja e Kurtit për Harrisin në Konventën e Demokratëve dëmton popullin e Kosovës”, ka shkruar Grenelli.



Për dhjetëra fëmijë me probleme në të folur kujdesen katër logopedë në QKUK

PRISHTINË, 20 GUSHT - Vetëm katër logopedë që trajtojnë fëmijët me probleme në të folur punojnë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ku shërbimet i ofrojnë falas.

Udhëheqësit e Shërbimit të Logopedisë kanë thënë se kërkesat për seanca logopedie e tejkalojnë disponueshmërinë e specialistëve dhe kjo bën që pritjet e atyre në nevojë të zgjaten.

Në institucionet private seancat 2-3 herë në javë, për një muaj, janë tejet të kushtueshme për disa. “Një logoped më ka kërkuar 500 euro në muaj”, tregon nëna e një vajze katër vjeçe, e cila ka vështirësi në artikulimin e fjalëve.

“Nuk kemi pasur mundësi t’ia ofrojmë, sepse në familjen tonë punon vetëm bashkëshorti me një pagë prej 350 eurosh në muaj”, ka thënë ajo, pa dashur të identifikohet.

“Radio Evropa e Lirë” ka biseduar me të në Shërbimin e Logopedisë në QKUK, ku po aranzhonte seancat për vajzën e saj. Në listë të pritjes ajo ka thënë se ishte për më shumë se një vit. “Vajza e kupton bisedën, reagon kur e thërret, por nuk flet”, ka treguar e ëma.

Ajo ka thënë se kur ishte tri vjeçe e vogla shqiptonte vetëm fjalët “mam” dhe “bab” dhe se vazhdon të artikulojë vetëm një numër të kufizuar fjalësh.

Specialistët kanë thënë se numri i fëmijëve me probleme në të folur është në rritje dhe këtë ia atribuojnë përdorimit të vazhdueshëm të pajisjeve teknologjike.

Këtë e ka pranuar edhe nëna e katërvjeçares. “Pa i bërë një vit ia kam lënë telefonin, por jo shumë, një ose dy orë në ditë. Shumë ka

dëshirë ta përdorë. Shikon filma të vizatuar”, ka thënë ajo.

Dhjetëra fëmijë në trajtim në QKUK

Ushtruesja e detyrës e sheshe së Shërbimit të Logopedisë në QKUK, Zahide Uka-Rraci, ka thënë se gjatë gushtit në këtë repart janë duke u trajtuar 72 fëmijë nga gjithë territori i Kosovës. Me ta, ka thënë ajo, merren katër logopedë. “Shumica e rasteve janë deri në moshën pesëvjeçare, të ndara në tri grupe. Shërbimet i marrin nga dy herë në javë”, ka treguar Uka-Rraci.

Duke folur për “Radion Evropa e Lirë”, ajo ka shpjeguar se gjatë seancave të stimulimit është vërejtur se përdorimi i teknologjisë dhe i aplikacioneve të ndryshme në gjuhën angleze, ka bërë që ata të kenë zhvillim të vonshëm në të folur. Sipas saj, prindërit i ekspozojnë fëmijët përpara ekranit të telefonit, kompjuterit apo televizorit me shpresën për t’i qetësuar, por ata “e dëmtojnë zhvillimin e tyre në të folur apo në të ndërvepruar me mjedisin”.

Uka-Rraci ka thënë se kjo është problematike për faktin se “fëmija vetëm merr informacione” dhe “nuk jep përgjigje”. “As telefoni, as televizori nuk i kërkon të shkëmbejë informata me të. Kështu, pastaj, shkaktohen vonesa apo hezitime në të folur”, ka thënë Uka-Rraci.

Argumentet e saj i mbështet edhe Lekë Gjurgjiali, kryetar i Shoqatës së Logopedëve të Kosovës. Sipas tij, përdorimi i tepërt i pajisjeve teknologjike i bën fëmijët pasivë. “Ata shpeshherë zgjedhin të



komunikojnë në mënyre joverbale, ose kanë qasje pa zë”, ka thënë ai.

Kur duhet të flasin fëmijët?

Doktoresha Uka-Rraci ka thënë se fëmijët nën moshën njëvjeçare flasin fjalë të ndara në rrokje si “ba-ba” apo “ma-ma”, dëgjojnë kur flitet dhe kuptojnë disa fjalë. Në moshën dyvjeçare, sipas saj, duhet të thonë fjalë të shkurtra sikurse “erdhi mami”, kurse mbi moshën trevjeçare duhet të kenë fjalor më të pasur dhe të kuptohen nga të tjerët.

“Nëse një fëmijë nuk flet deri në moshën dyvjeçare, ai duhet të bëhet objekt vlerësimi”, ka thënë Uka-Rraci. Studime të ndryshme ndërkombëtare kanë treguar, po ashtu, lidhje mes kohës së shpenzuar në ekran dhe vonesave në të folur.

Një raport që ka publikuar vitin e kaluar Biblioteka Kombëtare e Mjekësisë, që është pjesë e Departamentit Amerikan të Shëndetësisë, ka gjetur se “kur fëmijët kalojnë shumë kohë përpara ekranit, ata nuk ndërveprojnë me të tjerët” dhe kjo

“i kufizon mundësitë e tyre për të mësuar fjalë të reja dhe për të zhvilluar aftësi komunikimi”. “Kjo çon, pastaj, në fjalor të dobët, reduktime në vokalizimet e fëmijëve dhe vonesa ta përgjithshme në të folur, veçanërisht te fëmijët nën pesë vjeç”, është thënë në këtë studim.

Si duhet të stimulohen fëmijët?

Logopedia Uka-Rraci ka thënë se metoda më e mirë për t’i stimuluar fëmijët që të flasin është duke biseduar me ta gjatë gjithë kohës. “Për shembull, nga fëmija mund përfitohen fjalë kur ai është i uritur. Kur kërkon ushqim, duhet të pyetet se çka do? A do bukë? Të përsëritet së paku tri herë dhe të pritët reagimi”, ka shpjeguar ajo. Edhe psikologjia për fëmijë Majlinda Fetahu, njëherësh terapeute stimulimi, ka thënë se janë prindërit ata që duhet “t’i vendosin kufijt” përdorimit të teknologjisë. Sipas saj, fëmijëve më të vegjël se 18 muaj duhet t’u ndalohet përdorimi i teknologjisë, përveç bisedave me video; fëmijët e moshës 18 deri në 24 muaj mund ta përdorin atë në

sasi shumë të vogël, kryesisht për këngë, ndërsa fëmijët mbi 2 vjeç mund ta përdorin jo më shumë se një orë në ditë, së bashku me të rritur, në mënyrë që të flasin dhe të pyesin për atë që shohin.

Në Kosovë nuk ka të dhëna të sakta se sa është numri i fëmijëve me vonesa në të folur, por Uka-Rraci ka thënë se në dy vitet e fundit është rritur numri i atyre që presin për shërbime në QKUK. Ajo ka vlerësuar se autoritetet kompetente duhet të punësojnë më shumë logopedë në qendrat familjare dhe në institucionet edukative-arsimore në sektorin publik, ku shërbimet e tyre merren falas.

Në QKUK të gjitha rastet që marrin shërbime, sipas saj, janë me kushte më të vështira ekonomike apo me asistencë sociale. “Ata që kanë kushte më të mira financiare drejtohen te sektori privat dhe nuk presin”, ka thënë Uka-Rraci.

“Radio Evropa e Lirë” ka pyetur Ministrinë e Shëndetësisë dhe atë të Arsimit nëse planifikojnë ta rrisin numrin e logopedëve në kujdesin primar shëndetësor, përkatësisht në kopshte dhe shkolla, por nuk mori përgjigje prej asnjërit institucion.

Logopedët që punojnë në sektorin privat licencohen nga Oda e Infermierëve e Kosovës, por as ajo nuk i është përgjigjur pyetjes së “REL”-it se sa është numri i tyre. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, në Kosovë janë të licencuara 16 ambulanca private që ofrojnë shërbime të logopedisë. “REL”-i ka kontaktuar disa nga to, ku i është thënë se çmimet për shërbimet e logopedisë fillojnë nga 150 euro deri në 500 euro në muaj. Për krahasim, paga mesatare në Kosovë është rreth 520 euro.

Kurteshi: Kam parë fakte dhe dëshmi që Astrit Dehari është vrarë me urdhër nga lart

PRISHTINË, 20 GUSHT - Për më shumë se tri orë është intervistuar anëtari i Lëvizjes Vetëvendosje, Sami Kurteshi, nga Prokuroria Speciale, pas deklaratave të bëra lidhur me rastin e vdekjes së ish-anëtarit të kësaj lëvizje, Astrit Dehari.

Kurteshi ka thënë se intervistimi i tij është bërë në cilësinë e dëshmitarit, duke thënë se qëndron pas çdo deklaratë të bërë në konferencën për medie më 12 gusht. Ai ka thënë se ka parë mijëra faqe që dëshmojnë se Astrit Dehari është vrarë me urdhër të “ish-funksionarëve të

shtetit”.

“Jam intervistuar në cilësinë e dëshmitarit për deklaratat e bëra dhe të shkruara të publikuara më 12 gusht para Prokurorisë Speciale për pensionimin e të prokurorit Afrim Shefkiu që ka udhëhequr rastin e Deharit. Kjo ka shkuar me autorizim të prokurorit të rastit. Prokuroria Speciale ka caktuar prokurorin e ri për rastin e Deharit dhe ai është Bekim Kodraliu. Pyetjet kanë qenë në lidhje me deklaratat dhe prononcimin tim më 12 gusht në konferencën time të mbajtur para PSRK-së. Ka qenë një paragraf i



përdorur në konferencën për media dhe në komunikatën për media nga Lëvizja Vetëvendosje që ka të bëjë me implikimin dhe urdhrat e dhëna nga maja e shtetit për institucionet e

drejtësisë dhe të sigurisë në Kosovës”, ka thënë Kurteshi.

Ai ka këmbëngulur se mbrapa vdekjes së ish-aktivistit Astrit Dehari qëndrojnë ish-krerët e shtetit. “Unë jam përgjigjur në të gjitha pyetjet. Natyrisht që kam deklaruar dhe qëndroj pas çdo fjalie të dhënë më 12 gusht në atë konferencë. Ka shumë fakte që i dhashë në Prokurori, se implikimi i funksionarëve të majës së shtetit, bashkë me institucionet e sigurisë dhe drejtësisë, është i dukshëm nga të gjitha dëshmitë, provat, dokumentet që deri sot janë në dorë të publikut dhe në

dorë të institucioneve”, ka thënë Kurteshi, duke shtuar se ka parë fakte dhe dokumente që Astrit Dehari është vrarë.

“Unë nuk i kam ato fakte. Vetëm jam një nga personat që e përcjell rastin. Janë mbi tre mijë faqe, dokumente të ndryshme në lidhje me rastin, prova, analiza e rekomandime në lidhje me rastin Dehari. Shumicën prej tyre i kam lexuar dhe e kam përcjell rastin. Aty ka qindra dëshmi dhe fakte që vërtetojnë bindjen time që rasti i Deharit është vrasja e plotë me urdhër nga lart”, ka thënë Kurteshi / EO

Vazhdon aplikimi për subvencionimin e teksteve shkollore

Prishtinë, 20 gusht - Ministria e Arsimit ka bërë me dije se po vazhdon aplikimi për subvencionimin e teksteve shkollore në platformën “e-

Kosova”. Sipas ministrisë, deri të martën kanë aplikuar gjithsej 151 mijë e 80 prindër për subvencionim të teksteve shkollore. “Ndërkaq, lajm i mirë është

se tashmë janë ekzekutuar 81 355 pagesat e para dhe po vazhdohet edhe me transfere të tjera”, ka njoftuar Ministria e Arsimit. Sipas kësaj ministrie, asnjë nxënës

nuk do të mbetet pa tekste shkollore, pasi çdo rast i adresuar do të trajtohet me prioritet dhe do të ofrohet ndihma e nevojshme për përfitimin e mjeteve.



Çitaku: Pas ngritjes së aktakuzës për Nagip Krasniqin, PDK-ja kërkon hetim për mafinë energjetike

PRISHTINË, 20 GUSHT - Sekretarja e përgjithshme e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku (PDK), pas ngritjes së aktakuzës ndaj ish-kryeshefit të KEK-ut, Nagip Krasniqi, për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ka kërkuar llogaridhënie nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë skandal.

Çitaku në një konferencë për medie ka thënë se PDK-ja u jep mbështetjen e plotë organeve të drejtësisë, të cilat kanë marrë përsipër zbulimin e keqpërdorimeve milionëshe në këto tri vitet e fundit në fushën e energjisë.

“Të gjithë zyrtarët e lartë, ministra e ambasadorë, nën vëzhgimin e të cilëve kanë ndodhur skandalet, nuk kanë dhënë dorëheqje. Prandaj, sot Partia Demokratike e Kosovës kërkon llogaridhënie dhe përgjegjësi të plotë nga të gjithë akterët e përfshirë jo vetëm në këto skandale, por në të gjitha të cilat ende kërkojnë përgjigje: energjia, rezervat shtetërore, mos-deklarimet e

pasurisë, skandalet diplomatike, etj”, ka thënë ajo.

Sipas Çitakut, arrestimi i Nagip Krasniqit është maja e një ajsbergu, në të cilin i kanë rrënjët thellë eksponentë të rëndësishëm të këtij pushteti, që i ngjason një “mafie energjetike”. “Mos të harrojmë, në periudhën kur kjo qeveri ia shtrenjtoi energjinë elektrike për 100 për qind qytetarëve tanë, janë dy miqtë e mirë të kryeministrit Kurti të cilët erdhën në pozita udhëheqëse përmes favorizimeve të Lëvizjes Vetëvendosje, Nagip Krasniqi dhe ambasadori Martin Berishaj, të dyshuarit kryesorë në një skandal të pastër rajonal të korrupsionit masiv me tregtim të energjisë”, ka thënë ajo.

Çitaku ka rikujtuar rastet e shumta të keqpërdorimeve nga pushteti aktual dhe ngritjes së aktakuzave ndaj zyrtarëve të tij, duke thënë se para ligjit dhe drejtësisë, askush nuk guxon të jetë i paprekshëm. “Gjykata Themelore në Prishtinë dje ka konfirmuar aktakuzën për



mosraportim të pasurisë ndaj ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe zëvendëskryeministres së vendit, Donika Gërvallës. Tani, na thoni, si

mund ta quajmë ndryshe një pushtet, përveç se korruptiv, për të cilin nuk kalon asnjë muaj pa një skandal të madh të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Edhe një herë, mos

harroni: Të gjithë këta njerëz, edhe shumë të tjerë të cilët kanë defiluar gjatë këtyre viteve nëpër lajmet e skandaleve, asnjë nuk ka dhënë llogari”, ka thënë Çitaku.

LDK-ja premton se do t’ia “këpusë” rrënjët mafisë energjetike, AAK-ja zotohet për rritje të pagës minimale në 1 mijë euro

PRISHTINË, 20 GUSHT - Pasi presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka vendosur që më 9 shkurt të vitit të ardhshëm të mbahen zgjedhjet parlamentare, partitë politike edhe pse jo zyrtarisht kanë nisur fushatën parazgjedhore me premtime për rritje pagash e rrezim “të mafisë energjetike”.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, teksa ka akuzuar Lëvizjen Vetëvendosje për keqqeverisje në katër vitet e fundit, ka premtuar se nëse vjen në pushtet koalicioni AAK - Nisma, pas zgjedhjeve parlamentare, paga minimale në Kosovë do të jetë 1 000 euro deri në fund të mandatit qeverisës.

“Ne jemi bashkuar për t’ia kthyer Kosovës zhvillimin, për t’i rritur pagat e pensionet dhe për t’i ulur



taksat. Ne ditët e para të qeverisjes nuk do të ketë pagë mesatare nën 1 000 euro dhe nuk do të ketë asnjë pagë nën 500 euro. E deri në fund të mandatit, në vitin 2028, paga

minimale do të jetë 1 000 euro”, ka thënë Haradinaj.

Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka deklaruar se

“mafia energjetike” do të rrëzohet më 9 shkurt 2025, teksa ka përmendur aktakuzën e Prokurorisë Speciale ndaj ish-kryeshefit Korporatës Energjetike, Nagip Krasniqi, dhe hetimet ndaj ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, i cili dyshohet për një skandal financiar në Slloveni.

“Pas 9 shkurtit hetimet e pavarura të një sistemi juridik pa presion populist, do të japin dritë edhe mbi të gjithë tenderët sekret. Kemi ngritur mjaftueshëm fakte për 113 tenderët e tjerë sekret në KEK, dhe mbi 877 të tjerë në gjithë qeverinë për tre vite – pothuajse nga një në ditë”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.

Zgjedhjet e rregullta parlamentare do të mbahen më 9 shkurt 2025. Duke qenë se Kosova do ta hapë

sezonin zgjedhor së shpejti – një kohë kur qytetarët fillojnë t’i kushtojnë shumë vëmendje fushatës elektorale, ndërsa partitë politike i kthehen rutinës përgatitore për betejën e radhës – pritet të vazhdojë edhe “ping-pongu” mes pushtetit dhe opozitës për situatën në vend.

Kjo është hera e parë pas pavarësisë që në Kosovë organizohen zgjedhje të rregullta, duke qenë se të gjitha të tjerat ishin të jashtëzakonshme për shkak të dorëheqjeve të kryeministrave apo mocioneve të mosbesimit.

Zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë janë mbajtur më 14 shkurt të vitit 2021. Ato i kishte fituar në mënyrë plebishitare Lëvizja Vetëvendosje e drejtuar nga Albin Kurti me mbi 50 për qind.

Presidentja Osmani rithekson përkushtimin e Kosovës për anëtarësim në NATO

PRISHTINË, 20 GUSHT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim ndihmëssekretarin e përgjithshëm të NATO-s për çështje të jashtme dhe siguri, ambasadorin Boris Ruge.

Presidentja Osmani ka përsëritur mirënjohjen e Kosovës për kontributin e vazhdueshëm të NATO-s në Kosovë, ndërsa ka rithekësuar përkushtimin e Kosovës për anëtarësim në NATO.

Presidentja Osmani ka potencuar se Kosova është e gatshme t’i kontribuojë unitetit transatlantik në mbrojtje të vlerave të përbashkëta të pages,

demokracisë dhe lirisë.

Në takim është diskutuar edhe për çështjen e hapjes së urës së Ibrit, me ç’rast Osmani ka përsëritur se hapja e urës si akt normalizimi e integrimi është në interes të të gjithë qytetarëve pa dallim etnie.

Presidentja Osmani ka cekur rëndësinë e konsultimit dhe koordinimit në mes të institucioneve tona dhe partnerëve tanë të sigurisë, veçanërisht me NATO-n, në mënyrë që të ndërtohet plani i përbashkët i zbatimit për hapjen e urës.

Më tutje, presidentja Osmani e ka uruar Rugen për samitin e

suksesshëm të NATO-s në Uashington D.C., ku Republika e Kosovës është përfshirë për herë të parë në një sërë aktivitetesh në kuadër të samitit, me ftesë të presidentit Biden dhe sekretarit Blinken, e ku janë riafirmuar uniteti transatlantik dhe mbështetja e përbashkët për Ukrainën.

Po ashtu, presidentja Vjosa Osmani ka pritur të martën në takim edhe ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit, përfshirë çështjen e hapjes së urës së Ibrit.



Haradinaj, minatorëve të “Trepçës”: Do të jem gjithmonë krah jush

MITROVICË, 20 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vizituar të martën Sindikatën e Minatorëve të “Trepçës”.

Haradinaj ka thënë se “Trepça” është duke u ballafaquar me probleme serioze që ndërlidhen me mashtrimin që kjo qeveri po e bën tash e 4 vjet. “‘Trepça’ është vlerë dhe simbol i rëndësishëm i Kosovës. Kështu e kam trajtuar edhe atëherë kur në Kosovë kishte pak njerëz që besonin se ‘Trepça’ mund të rikthehej si aset i përhershëm i Republikës sonë. Gjatë mandatit tim si

kryeministër i vendit, në mars të vitit 2019, me votimin e Statutit të ‘Trepçës’ e regjistruam atë si kompani në bazë të ligjeve të Kosovës. Kjo ishte mënyra më e mirë për ta shpërblyer sakrificën e minatorëve të devotshëm dhe për t’i hapur rrugë zhvillimit të ‘Trepçës’. Sot ‘Trepça’ është duke u ballafaquar me probleme serioze që ndërlidhen me mashtrimin që kjo qeveri po e bën tash e 4 vjet. Ka mungesë të financave, minatorët përballen me kushte të rënda pune, të ardhura tejet minimale që nuk paguhen me muaj të tërë e pa sigurim shëndetësor”, ka thënë

Haradinaj.

Kryetari i AAK-së është zotuar se do të jetë krah në të gjitha kërkesat. “Në vizitën që i bëra Sindikatës së Minatorëve shpreha shqetësimin për gjendjen në të cilën gjenden sot minatorët. U zotova para tyre se do të jem krah në të gjitha kërkesat, sikur sot, por edhe nesër në udhëheqje të vendit. ‘Trepçës’ duhet t’i kthehet nami dhe shkëlqimi i dikurshëm përmes projekteve investive – revitalizimit të plotë dhe ofrimit të kushteve më të mira për minatorët”, është shprehur Haradinaj.



39 ndërmarrje përfitojnë nga dy skemat e granteve të reja të MINT-it

PRISHTINË, 20 GUSHT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka nënshkruar marrëveshjet për skemën e granteve për certifikimin e produkteve dhe atë të Iniciativës për Fuqizim Digjital.

Ministria e kësaj ministrie, Rozeta Hajdari, ka bërë me dije se nga të dy skemat kanë përfituar 39 ndërmarrje, ndërsa planifikohet të përfitojnë edhe 90 të tjera në të ardhmen.

Hajdari ka thënë se krijimi i ambientit për të bërë biznes të drejtë, konkurrues dhe të adaptueshëm është synim afatgjatë i ministrisë. Ajo ka theksuar se MINT-i ka hartuar edhe politikën industriale për shtatë sektorë prodhues, të cilët i ka cilësuar “yje në rritje” për

zhvillimin e zinxhirit global të blerjes. “Skema këto të përkrahura nga MINT-i, përmes Agjencisë për Investime dhe përkrahje të ndërmarrjeve dhe përkatësisht Iniciativës për Fuqizim Digjital që është në kuadër të projektit me mbështetje financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Krijimi i ambientit për të bërë biznes të drejtë, konkurrues dhe të adaptueshëm është synim afatgjatë i ministrisë”, ka thënë Hajdari, duke shtuar se transformimi strukturor është dinamika kyçe që shtyn rritjen ekonomike të shpejtë. “Prandaj në funksion të politikave industriale, tregtare, të ndërmarrësisë jemi duke zhvilluar sa më shumë



instrumente dhe skema mbështetëse. Për herë të parë në Kosovë MINT ka hartuar politikën industriale me vizion të qartë deri në vitin 2030. Janë shtatë sektorë prodhues, përpunues, që janë si yje në rritje për të zhvilluar zinxhirin global të blerjes. Politika

industriale 2030 ka për qëllim transformimin infrastrukturor të industrisë vendore në një industri më të integruar globale që është në gjendje t’i prodhojë produktet me vlerë të lartë të shtuar dhe të shtojë punësim të denjë për të rinjtë tanë”, ka thënë Hajdari.

Ajo ka thënë se bizneset përfituese të certifikimit të produkteve në kuadër të shtatë sektorëve të strategjisë për zhvillim industrial dhe mbështetje të biznesit synojnë të kontribuojnë në rritjen e prodhimit dhe përpunimit, përmirësimin e bilancit tregtar nëpërmjet eksporteve të larta. “Përmes skemës së certifikimit të produkteve kanë përfituar 6 ndërmarrje të cilat do ta nënshkruajnë marrëveshjen sot. Planifikojmë përkrahjen edhe të 20 ndërmarrjeve. Në kuadër të projektit për fuqizim digjital, kanë përfituar 33 ndërmarrje për shërbime digjitale në vendin tonë. Planifikojmë të përkrahim edhe 70 ndërmarrje të tjera”, ka thënë Hajdari.

Shahini: Kompanitë e Kosovës kanë filluar të investojnë në veri, integrimi bëhet përmes bizneseve

PRISHTINË, 20 GUSHT - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka thënë se bizneset e Kosovës kanë filluar të investojnë në veri, sidomos pas penisë së shtuar të organeve të rendit. Shahini ka deklaruar se brende të fuqishme të Kosovës kanë filluar të blejnë prona private, por edhe përmes privatizimit.

Ai ka vlerësuar se integrimi i veriut të Kosovës mund të bëhet përmes ekonomisë. “Tashmë bizneset e Kosovës kanë filluar të investojnë në veri sepse AKB-ja gjithmonë ka



thënë që integrimi i veriut bëhet përmes bizneseve dhe kjo tash ka filluar të ndodhë pas rrënimit të

disa strukturave paralele serbe atje, e sidomos pas 24 shtatorit të vitit të kaluar kur Policia e Kosovës

është tashmë aktive dhe pothuajse ka në kontroll gjithçka. Tash është një mundësi e re e investimeve në veriun e vendit. Bizneset e Kosovës tash kanë filluar të blejnë prona atje, qoftë private apo edhe përmes procesit të privatizimit, por së shpejti atje do të ketë disa biznese, brende të fuqishme të Kosovës, të cilat do të operojnë edhe në gastronomi, hotelieri, shitje me pakicë e me pika të karburanteve”, ka thënë Shahini për “EO”.

Kreu i AKB-së ka thënë se janë në komunikim të vazhdueshëm me

institucionet e sigurisë për të mundësuar zhvillim të qëndrueshëm të bizneseve. “Kjo nuk është informatë, është realitet që po ndodh në terren. Edhe me ministrin e Punëve të Brendshme (Xhelal Sveçla) jemi në komunikim të vazhdueshëm. Kemi memorandum bashkëpunimi për të bërë një veprim të tillë dhe tashmë bizneset e kanë orientimin, një mundësi të re dhe kjo mundësi e re do të jetë veri i Kosovës për t’i zhvilluar bizneset e për të blerë prona”, ka thënë Shahini.

Bashkatdhetarët këtë vit dërguan më pak para

PRISHTINË, 20 GUSHT - Remitenat gjatë këtij viti kanë pësuar rënie krahasuar me vitin e kaluar. Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti të ardhurat nga bashkatdhetarët kapin vlerën rreth 120 milionë euro krahasuar me 124 milionë sa ishin gjatë vitit 2023.

Përfaqësues të bizneseve shprehen të shqetësuar se sivjet pati më pak bashkatdhetarë, derisa thonë se ata janë infuzion për ekonominë e vendit. Pushimet edhe sivjet i kaluan në Kosovë, megjithëse mërgimtarët kësaj here sollën më pak para. Të

dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se vlera e remitenave gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti ishte 119.71 milionë euro krahasuar me 124 milionë euro sa kishte qenë në periudhën e njëjtë të 2023-s. Shpresat për ringjallje financiare bizneset

edhe këtë vit i patën të mërgimtarët, për çfarë janë shprehur të shqetësuar se sivjet ardhja e tyre është vonuar. Mirëpo nga Oda Ekonomike e Kosovës kanë thënë se presin që gjendja të stabilizohet gjatë dy muajve të ardhshëm. Më së shumti dërgesa të parave në



Kosovë ka pasur nga Gjermania, Zvicra, Italia dhe Austria.

George F. KENAN : Memoare 1925-1950 (4)

Çfarë u kishte thënë Stalini punëtorëve amerikanë?



Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

Thekse nga porosia telegrafike nga Moska e datës 22 shkurt 1946

Duke marrë para sysh ngjarjet e mëhershme, besoj se Departamentit do t'i jenë të dobishme vërejtët, vrojtimit e mëposhtme:

I. Karakteristikat kryesore të zhvillimeve sovjetike të pasluftës, ashti siç i propagandon aparati i BRSS-së. A. BRSS edhe më tej jeton në “rrethimin kapitalist” antagonist me të cilin së fundi nuk mund të ketë koekzistencë të përhershme paqësore. Stalini, në vitin 1927 këtë e kishte formuluar, shprehur kësioj në takimin me një delegacion e punëtorëve amerikanë:

“Gjatë zhvillimit të mëtejshëm të revolucionit ndërkombëtar do të formohen dy kampe të rëndësishme botërore: një socialiste, e cila kah vetja do të tërheq vendet të cilat duan kah socializmi, dhe një kapitaliste, e cila kah vetja do të tërheq vendet të cilat anojnë kah kapitalizmi. Lufta midis këtyre dy kampeve rreth rolit kryesor në ekonominë botërore do ta zgjidh fatin e kapitalizmit dhe komunizmit në mbarë botën”.

B. Bota kapitaliste është e përfshirë me konflikte të brendshme të cilat janë pjesë përbërëse natyrës së shoqërisë kapitaliste. Ato konflikte nuk mund të zgjidhen me marrëveshje paqësore. Prej tyre, konflikti më i madh është midis Anglisë dhe ShBA-së.

C. Konfliktet e brendshme të kapitalizmit patjetër, në mënyrë të paevitueshme lindin luftëra. Luftërat e tilla të paraqitura mund të jenë të dy llojta: luftërat ndërkapitaliste midis dy shteteve kapitaliste dhe luftërat intervenuese kundër botës socialiste. Kapitalistët dinak, duke u përpjekur së koti që të evitojnë konfliktet e brendshme në kapitalizëm, janë të prirë në llojin e dytë të luftërave.

D. Intervenimi kundër BRSS-së, edhe pse ishte fatale për ata të cilët eventualisht do ta ndërmerrnin, do të nxiste një ngecje të re në zhvillimin e socializmit sovjetik, prandaj me çdo kush duhet të pengohet.

Rusët thoshin se bota kapitaliste është e keqe!

E. Për BRSS-në edhe konfliktet midis shteteve kapitaliste janë përplot rreziqe, mirëpo përkundër kësaj ato afrojnë mundësi të mëdha për përparimin e çështjeve të socializmit, veçmas nëse BRSS-ja ushtarakisht ngel e fortë, ideologjikisht unike dhe besnike udhëheqjes tanishme të saj gjeniale.

F. Duhet pasur në vëmendje se e tërë bota kapitaliste nuk është e keqe. Përpos elementeve reaksionare dhe borgjeze në te, pra në shoqërinë kapitaliste ka 1) disa elemente pozitive dhe të vetëdijshme të bashkuara të pranueshme për partitë komuniste, dhe 2) disa elemente tjera (të cilat tani për shkak të arsyeve taktike, quhen të përparuar dhe demokratike) reaksionet e të cilave, synimet dhe veprimtaritë falë rrethanave të krijuara “objektivisht” janë të dobishme për interesat e BRSS-së. Ato duhet nxitur dhe duhet shërbyer me to me qëllim të arritjes së qëllimeve të Bashkimit Sovjetik.

G. Ndër elementet negative të shoqërisë borgjeze-kapitaliste më të rrezikshmet janë ato të cilat Lenini i ka quajtur miq të rrejshëm të kombit, pa fjala është për udhëheqësit e matur të socialistëve dhe socialdemokratëve (me fjalë tjera, të majtët jokomunistë). Ata janë më të rrezikshëm sesa reaksionarët e fundit, sepse këta të dytë së paku marshojnë nën flamujt e tyre të vërtetë, derisa udhëheqësit e të majtëve të matur e mashtrojnë popullin duke shërbyer me mendimet e socializmit për t'u shërbyer interesave të reaksionet kapitalist.

Kaq për premisat. Deri te çfarë konkluzë ato shpijnë nga aspekti i politikës sovjetike? Deri të këto konkluzë:

A. Duhet ndërmarrë gjithçka, çdo gjë në mënyrë që edhe më tej të forcohej fuqia ndikuese e BRSS-së si faktor në marrëdhëniet ndërkombëtare. Dhe anasjelltas, nuk duhet lejuar asnjë rast që mundëson të dobësohet forca e ndikimit të shteteve kapitaliste, si në tërësi ashtu edhe në veçanti.

B. Bashkimi Sovjetik dhe miqtë e tij në botën e jashtme duhet t'i orientojnë përpjekjet e tyre në thellimin dhe shfrytëzimin e mospajtimeve dhe konflikteve midis shteteve kapitaliste. Nëse këto konflikte rriten në luftë “imperialiste”, ajo luftë duhet të shndërrohet në kryengritje revolucionare përbrenda shteteve kapitaliste.

C. Elementet “demokratike – përparimtare” jashtë vendit duhet shfrytëzuar ashtu që ato me presionin e tyre të orientojnë qeveritë kapitaliste në linjat të cila u përgjigjen interesave të Bashkimit Sovjetik. D. Kundër udhëheqësve socialist dhe socialdemokrat jashtë vendit duhet udhëhequr luftë të pamposhtur.

Direktivat - në frymën e linjës së Partisë komuniste ruse

II. Bazat e atyre koncepteve, mendimeve, opinioneve Para se të shqyrtojmë se si kjo linjë partiake përpunohet në praktikë, duhet tërhequr vëmendjen në disa aspekte të saj.

E para, ajo nuk është shprehje, manifestim i koncepteve, mendimeve, vështrimeve të popullit rus. Populli kryesisht është miqësisht i orientuar, përcaktuar botës së jashtme, i etshëm që ta përjetoj, i etshëm që me të t'i mat aftësitë e veta për të cilat është i vetëdijshëm, dhe është i tanishëm të jetoj në paqe dhe të gëzoj frytet e angazhimit, përpjekjes së tij. Linja partiake paraqet vetëm tezën të cilën aparati zyrtar propagandues me shumë shkathtësi dhe me konsekuencë ia imponon publikut, shpesh me rezistencë në kullën e mendimit të tij më intime. Mirëpo linja e partisë detyron, obligon në qëndrime dhe mbajtjen e njerëzve dhe të pushtetit – kurs ene kemi punë kryesisht, në radhë të parë me ta.

E dyta, duhet theksuar se premisat mbi të cilat bazohet ajo linjë partiake në pjesën më të madhe, thjesht nuk janë të sakta. Përvoja ka dëshmuar se koekzistenca paqësore dhe e qetë e shteteve kapitaliste dhe atyre socialiste është plotësisht e mundur. Konfliktet themelore të brendshme në vendet e zhvilluara më nuk janë ato të cilat dalin, burojnë nga pronësia kapitaliste ndaj mjeteve të prodhimit, mirëpo ato të cilat dalin nga zhvillimi i urbanizimit dhe industrializimit, kurse me të këtilla Rusia deri më tani ka qenë e kursyer jo duke ju falënderuar socializmit, por prapambeturisë së vet. Kundërshtimet, rivalitetet përbrenda kapitalizmit gjithnjë nuk lindin, nxjerrin luftëra, dhe as që gjithnjë të gjitha luftërat mund t'i përshkruhen shkaqeve, motiveve, arsyeve të tilla. Të flasësh sot, për mundësitë e intervenimit kundër BRSS-së pas eliminimit të Gjermanisë dhe Japonisë dhe

pas shembujve të luftërave të mëparshme, është diçka e kotë, është budallallëk. Sikur forcat e mosdurueshmërisë, të mospajtimeve dhe të subversionit nuk do ta kishin nxitur, bota e sotme “kapitaliste” do të ishte plotësisht e aftë që të jetonte në paqe dhe në suazat e veta, pra edhe me Rusinë. Së fundi, askush i mençur, i arsyeshëm nuk ka arsye të dyshojë në sinqeritetin e udhëheqësve të matur socialist në vendet perëndimore. As që është e ndershme korrekte të mohohet suksesi i përpjekjeve të tyre që të përmirësojnë kushte e jetës të popullit punues, gjithkund ku, sikur në shtetet Skandinave, u është dhënë rasti që të dëshmojnë se çfarë mund të bëjnë.

Rusët nuk dinë të sundojnë pa diktaturë!

Rusët vazhdimisht ushqehen me iluzionet dhe mashttrimet e ideologjisë marksiste. Për ata të gjithë perëndimorët janë armiq, janë një botë e keqe që duhet të vdes! Rusët janë të pakapërcyeshëm për intriga, komplete e tradhti të gjitha llojeve, jo vetëm politike.

Pikëvështrimi neurotik i Kremlinit ndaj situatës në botë

Josaktësia e atyre premisave, të cilat të gjitha rrjedhin që para luftës së kaluar, pikërisht i ka vërtetuar, gjerësisht ai konflikt. Konfliktet, mosmarrëveshjet anglo - amerikane nuk janë rritur në kundërshtimet më të rëndësishme të botës kapitaliste. Fuqitë kapitaliste, përveç fuqive të Boshtit, nuk kanë treguar kurrfarë afiniteti, interesimi, gatishmërie që konfliktet reciproke t'i pajtojnë me luftë të përbashkët kryqëzatash kundër BRSS-së. Në vend se lufta imperialiste të shndërrohet në luftëra qytetare dhe në revolucione, BRSS-ja ishte e detyruar të luftojë krah për krah me fuqitë kapitaliste për qëllimet e përbashkëta të proklamuar. Megjithatë, sot të gjitha ato teza, pikëpamje pavarësisht se në çmasë janë pa mbështetje dhe pavarësisht se sa i demanton realiteti, edhe më tej me vendosmëri po zgjerohen. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se, linja e partisë sovjetike nuk bazohet, nuk mbështetet në analizën objektive të situatës sa i përket rreth çështjes së kufijve rus, se ajo fare pak kujdeset, merr parasysh kushtet,

rrethanat jashtë Rusisë, se del, buron kryesisht nga nevojat e brendshme themelore ruse të cilat kanë ekzistuar para luftës së kaluar dhe që ekzistojnë edhe sot.

Në themel të pikëshikimit neurotik, të Kremlinit ndaj zhvillimeve botërore shtrihet ndjenja instiktive dhe tradicionale ruse e pasigurisë. Fillimisht kjo ishte pasiguri e një populli paqedashës fshatar i cili është përpjekur të jetonte në fushën e shtrirë i rrethuar me fqinjë luftarak nomad. Kur Rusia kishte hyrë në marrëdhënie, raporte me Perëndimin ekonomikisht më të përparuar, atëherë këtij procesi i ishte bashkangjitur frika, shqetësimi nga më të aftit, më të fuqishmit, nga bashkësitë shoqërore më të organizuara në atë pjesë, territor. Mirëpo, ajo pjesë e dytë e pasigurisë më tepër e kishte goditur pushtetmbajtësit, sunduesit rus sesa popullin rus, sepse pushtetmbajtësit gjithnjë kishin ndje se mënyra e sundimit sipas formës relativisht u është arkaikë, e pa aftë të mbaj krahësimet me përmbajtjet politike të vendeve perëndimore. Prandaj ata gjithnjë i janë frikuar depërtimit nga jashtë, takimit të drejtpërdrejt midis botës perëndimore dhe botës së tyre, i frikoheshin asaj që do të mund të ndodhte nëse rusët do të dinin të vërtetën për botën e jashtme ose nëse të huajt do të dinin të vërtetën për jetën në Rusi. Edhe ata kanë mësuar të kërkonin siguri vetëm në luftën e durueshme dhe të paimagjinuar për shkatërrimin e plot të rivalit, konkurrentit, dhe jo në marrëveshjen dhe kompromisin me te.

Në emër të marksizmit rusët viktimizuan secilën vlerë

Marksizmi, i cili gjysmë shekulli pa sukses qëndroi në Evropën Perëndimore, rastësisht nuk kishte gjetur për herë të parë vend të përshtatshëm në Rusi ku edhe do të shpërthejë. Vetëm në atë vend, i cili kurrë nuk ka ditur se çfarë është fqinjësia miqësore e orientuar, ose së paku ekuilibrimi i durueshëm, e matur, qoftë e brendshme ose ndërkombëtare, ka mundur të zë rrënjë doktrina e cila konsideron se kundërthëniet ekonomike të shoqërisë nuk mund të zgjidhen me mjete paqësore. Pas vendosjes së regjimit bolshevik, dogma marksiste – e cila në interpretimin e Leninit u bë edhe më e ashpër, më e vrazhde, dhe më jotolerante – ishte mjet i

përkryer për bartjen, përcjelljen e ndjenjës së pasigurisë me të cilën bolshevikët ishin të zënë, përfshirë madje më tepër se sa pushtuesit e mëhershëm. Në atë dogmë, me bazën, me qëllimet e saj themelore altruiste, ata kishin gjetur arsytim për frikën e tyre nga bota e jashtme, për diktaturën pa të cilën nuk kanë ditur të sundojnë, për ashpërsinë, vazhdimësinë të cilën nuk morën guxim ta hiqnin, largonin, zhduknin, për viktimat të cilat për mendimin e tyre me të drejtë ishin kërkuar. Në emër të marksizmit ata kishin viktimizuar, secilën vlerë të veçantë etike në metodat dhe në taktikën e tyre. Sot ata nuk munden pa te. Ai është një gjethe fiku e autoritetit, pasqyrës së tyre morale dhe shpirtërore. Pa te ata do të rrinin, qëndronin para historisë në rastin më të mirë vetëm si sundues të cilët me fuqinë, pushtetin e pamëshirshëm e kanë ndjekur vendin e tyre drejt shkallëve më të larta të fuqisë ushtarake me qëllim që regjimit

të brendshëm të dobët t'ia garantonin sigurinë. Për këtë, qëllimet sovjetike rregullisht duhet të ushqehen me mashtrimet e marksizmit dhe për këtë askush nuk guxon t'i nënçmoj rëndësinë e dogmës në punët sovjetike. Kështu, udhëheqësit sovjetik të nxitur, nën presionin e nevojave të pozitës së tyre të tashme dhe të mëhershme duhet të veprojnë me dogmë sipas të cilës bota e jashtme është e keqe, i disponuar armiqësisht, mirëpo në të njëjtën kohë në veti bart shenjat e sëmundjes vdekjeprurëse prandaj i është e gjykuar të shkatërrohet dhe të bie në situata gjithnjë e më të rënda, deri atëherë kur grushtin përfundimtar nuk ia japin forcat gjithnjë e më të fuqishme të socializmit dhe derisa nuk t'i dorëzohet botës së re dhe më të mirë. Kjo tezë ofron arsytim për rritjen e fuqisë, forcës ushtarake dhe policore në shtetin rus, për izolimin e opozitarëve rus nga bota e jashtme dhe për animin,

synimin fluid, konstant që të zgjerohen kufijtë e fuqisë, pushtetit të policisë ruse, që ndryshe është pjesë e synimeve, aspiratave dhe e instiktive të brendshme të pushtetmbajtësve rusë. Në esencë, ky është vetëm ekzistim i zhvillimit të nacionalizmit të paqetësuar rus, lëvizje e vjetër me shekuj. Mirëpo, i mbështjell në rrobat e reja të marksizmit internacional, me ndjenjat e veta të përziera, të ëmbëlsuara të demoralizuar edhe në luftën me botën e jashtme, ai nacionalizëm është më i rrezikshëm sesa kurdoherë më parë.

Rusët janë mjeshtër të pakapërcyeshëm për intriga dhe komplete!

Nga ajo që është thënë deri më tash nuk do të duhej përfunduar, konkluduar se, të gjithë ata që luftojnë për linjën e partisë sovjetike janë të vetëdijshëm, ndërgjegjshëm për

josingëritetin dhe jondershmërinë e saj. Shumica prej tyre tepër pak dinë për botën e jashtme, dhe edhe shpirtërisht janë tepër jo të pavarur, që të hetonin atë autohipnozë, prandaj nuk u është vështir ta bindin veten në atë se çfarë ju duket e mirë, dhe e këndshme për ta besuar. Së fundi, ende nuk është sqaruar fshehtësia se kush në këtë vend të madh vërtetë pranon informatat e sakta për botën e jashtme, nëse të tilla veç ka. Në atmosferën e fshehtësisë orientale dhe të konspiracionit e cila e përfshinë këtë pushtet, mundësitë e kthimit ose të helmimit të burimeve ose të ngjarjeve, zhvillimeve të informacionit janë të mëdha. Vetë fakti i nënçmimit të të vërtetës objektive - në realitet, dyshimi i tyre se ajo ekziston - rusët i detyron në atë që të gjitha faktet të cilat dikush i paraqet t'i mbajnë si mjet për arritjen e këtij apo atij qëllimi. Ekzistojnë arsye të mjaftueshme për parashikimin se ky pushtet

është tradhti brenda tradhtisë, komplot, brenda komplotit, dhe është vështir të besohet se vet Stalini pranon diçka që i ngjan pamjes objektive të botës së jashtme. Prandaj, nga kjo edhe është hapësira e gjerë për ato intriga në të cilat dhe për të cilat rusët anë të pakapërcyeshëm, të pakaluar, të pakonkurrencë. Pamundësia që qeveritë e jashtme të paraqesin qëndrimin e tyre para hartuesve, krijuesve të politikës ruse - shkalla në të cilën ato qeveri, në marrëdhëniet e tyre me Rusinë, i janë ekspozuar në mëshirë dhe jomëshirë me këshilla të fshehta dhe të paditura të cilat kurrënjëherë nuk i shohin dhe në të cilat nuk mund të ndikojnë - këto janë karakteristika shumë shqetësuese, të papërshtatshme të diplomacisë në Moskë, karakteristika të cilat burrështetasit perëndimorë duhet t'i kenë parasysh nëse dëshirojnë ose jo ta kuptojnë natyrën e vështirësive në të cilat me këtë rast has diplomacia.

(Vijon)

Hakmarrja (dhe mësimet) e Hillary Clinton në Çikago



Nga Marilisa PALUMBO,
Corriere della Sera


Një tjetër kalim i stafetës mbrëmë në skenën e Unity Center në Çikago, përveç asaj nga Biden te Harris, ishte ajo nga e para, Hillary Clinton, dhe kandidatet së dytë grua për presidente. E buzëqeshur, e relaksuar, Hillary u mirëprit me një ovacion dhe përzemërsi që dukej edhe më e vërtetë se kur ajo

konkurronte kundër Trump. Dhe ish-zonja e parë, senatorja dhe sekretarja e shtetit ka shumë mësimet për të ofruar se çfarë do të thotë të luftosh kundër mizogjenit Donald. I gjithë fjalimi dukej si një hakmarrje e shijshme ndaj njeriut që i hoqi ëndrrën e përgjeshme të vjetër më parë: të ishte ajo që do të thyente tavanin prej xhami duke u bërë presidentja e parë amerikane. Një "kriminel egoist" që fjeti gjumë

gjatë gjyqit të tij "dhe kur u zgjua, ai hyri në histori: u bë personi i parë që kandidoi për president me 34 dënime penale". Dhe aty turma shpërtheu në korin "mbylleni atë", duke përmbytur sloganin që Trump përdori kundër saj dhe të cilin së fundmi e ricikloi duke e përdorur kundër Kamala Harris. "Nuk është për t'u habitur," tha Clinton, "që ai gënjen për CV e Kamalës, që tallet me emrin dhe të qeshurën e saj. Mua më tingëllon e

njohur", tha ajo për të qeshurën bashkëfajtoreshë të arenës. Por mësimi më i madh që mund të tregojë Hillary, i cili gjithashtu tingëllon si një paralajmërim në festën e madhe të Çikagos, është: mos jini të sigurt për fitoren, mos u përgjallni nga sondazhet pozitive, "mos u hutoni". Ajo që i ishte afuar kaq shumë, kishte fituar votën popullore, e di se çfarë do të thotë të gabosh nga ana e besimit të tepërt, dhe mbrëmë duhet të ketë qenë po

aq e hidhur sa ishte për Biden që t'ia kalojë pishtarin Kamalës. Por Hillary nuk duket më si grua e shkatërruar e muajve pas asaj disfatë të papritur, mbrëmë ajo dukej e qetë, krenare, sepse edhe ajo po ndjek hapat e saj, dhe ato të grave që kanë thyer barrierat si Shirley Chisholm dhe Geraldine Ferraro, të dyja. përmendi në fjalimin e saj, se Harris mund të shpresojë të hyjë në Shtëpinë e Bardhë si numër një.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Osmani ia dorëzon flamurin lojtarit që do ta përfaqësojë Kosovën në Lojërat Paralimpike ‘Paris 2024’



Prishtinë, 20 gusht - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka dorëzuar flamurin lojtarit të Komitetit Paralimpik të Kosovës, i cili këtë muaj do të udhëtojë në Paris të Francës për Lojërat Paralimpike “Paris 2024”. Osmani ka thënë se me dorëzimin e këtij flamuri paraatletit Grevist Bytyqi, tregon mbështetjen e të gjithë popullit të Kosovës për këtë përfaqësim që do t’ia bëjë ai Kosovës në këto lojëra. Ajo është

shprehur e bindur se Kosova do të përfaqësohet dinjitetshëm dhe se do të shkëlqejë siç ka shkëlqyer çdoherë në arenën ndërkombëtarë nëpërmjet sportistëve. “Nëpërmjet dorëzimit të këtij flamuri dua ta tregoj mbështetjen të gjithnjë popullit të Kosovës për këtë përfaqësim. Të gjithë do të brohorasin për ty, të gjithë do të jemi me ty, jemi krenar që Kosova do të përfaqësohet në Lojërat Paralimpike. Ka qenë sukses

historik i Kosovës anëtarësimi i Kosovës në Komiteti Paralimpik. Edhe pse po marrim pjesë vetëm me një atlet. Është vërtet përfaqësim historik dhe jam e bindur që do ta përfaqësosh Kosovën dinjitetshëm dhe Kosova do të shkëlqejë siç ka shkëlqyer çdoherë në arenën ndërkombëtare nëpërmjet sportistëve tanë”, ka thënë Osmani. Më 28 gusht ekipi i këtij Komiteti do të debutojë në Lojërat Paralimpike “Paris 2024”.

Zeka pasi mori çmimin ‘Ylli i javës’: Suhareka do të bëjë bujë në futbollin e Kosovës

Prishtinë, 20 gusht - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, po vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e dytë i ka takuar futbollistit të FC Suharekës, Mevlan Zeka. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Milaim Humolli, Nail Kodraliu dhe Agim Xhakolli. Zeka e fitoi këtë çmim pasi realizoi dy gola, duke i siguruar fitoren e parë ekipit të tij debutues në Superligë, FC Suharekës, ndaj Dukagjinit (3-1). “Së pari, falënderoj komisionin për vlerësimin si më i miri i javës. Kjo ishte një fitore historike për klubin e Suharekës, pasi është një skuadër e re që po merr pjesë në Albi Mall Superligën e Kosovës. Duhet të kemi kujdes në çdo ndeshje, pasi Superliga është një nivel shumë më të lartë se Liga e Parë dhe kundërshtarët dinë të ndëshkojnë në çdo moment. Momenti i golit në minutën e 50 ishte i duhuri dhe më



pas e menaxhuam lojën mirë. Suhareka është një skuadër e organizuar mirë, edhe pse e re, brenda ka lojtarë me shumë përvojë dhe besoj se këtë vit do të

arrijmë objektivat e klubit. Shpresoj që Suhareka edhe në të ardhmen do të bëjë bujë në futbollin e Kosovës”, ka thënë Zeka për faqen zyrtare të FFK-së.

SHKURT

Ferizaj e transferon sulmuesin Abdul

Skuadra e Ferizajt është përforcuar në fazën ofensive. Ferizajasit kanë njoftuar se kanë arritur marrëveshje me sulmuesin Abdeen Temitope Abdul, i cili së fundmi ka luajtur në Islandë tek ekipi Dalvik. “FC Ferizaj me kënaqësi ju njofton se ka arritur marrëveshje me sulmuesin Abdeen Temitope Abdul. Abdul së fundmi ishte pjesë e skuadrës Dalvik në Islandë, kurse në edicionin 2022/23 ishte pjesë e Skënderbeut ku në 24 ndeshje shënoi 12 gola. Me transferimin e sulmuesit Abdul ne e kemi shtuar cilësinë në fazën ofensive”, thuhet në njoftimin e Ferizajt.

Gjini përforcon Ballkanin

Kampioni i Kosovës në futboll, Ballkani, ka përforcuar fazën defansive me një tjetër blerje të re. Suharekasit kanë siguruar shërbimet e Elmando Gjinit i cili deri më tani ishte pjesë e skuadrës shqiptare, Teuta. Arritja e marrëveshjes është konfirmuar nga vetë klubi i Teutës përmes një njoftimi në faqen zyrtare. “Klubi i futbollit Teuta njofton arritjen e marrëveshjes me FC Ballkanin për transferimin e Elmando Gjini në kampionatin kosovar të futbollit. Transferimi i mbrojtësit 21-vjeçar është arritur ditën e sotme”, thuhet në njoftim.

Shaqiri pritët si hero nga tifozët e Bazelit

“Blick” i ka kushtuar mjaft hapësirë rikthimit të Xherdan Shaqirit te Bazeli dhe priten që i është bërë nga tifozët e klubit në fjalë. “A është ai shpëtimtari? A është ai shpëtimtari që do të sjellë momente të lavdishme në FCB? Kjo mbetet për t’u parë, por shpresat qëndrojnë te Xherdan Shaqiri i madh”, shkruan “Blick”. Përmasat e një lojtari si Xherdan Shaqiri vihen re qartë nga mënyra si u mirëprit nga mijëra tifozë të Bazelit rreth stadiumit të klubit. Ai i përshëndeti me dorë tifozëve si një mbret nga ballkoni i zyrave të FCB. “Është gjithmonë mirë të jesh në shtëpi. Ka pasur gjithmonë vetëm një opsion për mua, FC Basel!”, ka thënë Shaqiri.

Kosova mposhtet nga Koreja e Jugut në hendboll

Hendbollistet e Përfaqësueses U18 të Kosovës e kanë humbur ndeshjen e fundit në fazën e dytë grupore në Kampionatin Botëror në Chuzhou të Kinës. Të martën në orët e para të mëngjesit, hendbollistet tona i kishin përballë hendbollistet e Koresë së Jugut. Koreja e Jugut fitoi me rezultat 31:21. Jugkoreanet pjesën e parë e fituan 14:11, ndërsa dallimi u bë në pjesën e dytë që përfundoi 17:10 për aziatiket. Diona Dreshaj i shënoi 10 gola nga 13 tentime për Kosovën. Ajo u shpall më e mira e ndeshjes. Arjeta Imeraj i kishte 3 gola nga 5 tentime, kurse Orgesa Gola realizoi 2 herë nga 3 tentime. Me 4 pikë, Kosova U18 përfundoi në vendin e dytë të Grupit II të “President’s Cup”, ku garohet për pozitat prej 17 deri në 32. Grupin e fitoi Koreja e Jugut me 6 pikë. India përfundoi e treta me 2 pikë, kurse Kanadaja e fundit, pa pikë. Kosovën e presin edhe dy ndeshje në Botëror, për plasman përfundimtar nga pozitat prej 21 deri në 24. Ndeshjen e radhës vashat “dardane” e kanë të enjten. Bilanci i tyre i deritashëm në Botëror është dy fitore dhe tri humbje.

Dalin në shitje biletat për ndeshjen Ukrainë - Shqipëri

Tiranë, 20 gusht - Shqipëria do ta nisë rrugëtimin në UEFA Nations League më 7 shtator në transfertë ndaj Ukrainës, sfidë që do të luhet në Çeki në stadiumin “Epet Arena”, duke nisur nga ora 20:45. Federata Shqiptare e Futbollit dëshiron

t’i njoftojë të gjithë futbolldashësit dhe tifozët e Kombëtares se nga sot do të kenë mundësi t’i blejnë biletat e tyre edhe për sfidën e parë në Grupin B1 të UEFA Nations League, Ukrainë - Shqipëri në fshf.org në linkun

<https://fshf.org/shop/>. Çmimi i biletës në “fans away sector” është 1 200 lekë (12 euro). Biletat janë elektronike dhe do t’ju dërgohen në “email”-in tuaj tri ditë përpara ndeshjes më 4 shtator. Procesi i shitjes së biletave vijon edhe

për ndeshjen e dytë të Shqipërisë në grupin B1 ndaj Gjeorgjisë. Ky takim do të luhet më 10 shtator në stadiumin “Air Albania”, në orën 20:45 dhe të gjithë tifozët kanë mundësi t’i blejnë biletat e tyre për këtë sfidë në linkun: ebileta.al.



Muriqi: Krenar që i shënova Realit

Mallorca, 20 gusht - Vedat Muriqi në fundjavë ishte përballë yjeve më të mëdhenj të botës, atyre të Realit, por gjithsesi shkëlqeu më shumë se ata. Në krahun tjetër, me fanellën e famshme madrilene ishin Mbappe, Bellingham, Vinisius apo Rodrigo, veçse kjo nuk e trembi aspak sulmuesin e Kosovës, që shënoi gol në barazimin e madh të Mallorcas. Përfundoi 1-1 ndeshja e javës së parë të La Ligës, dhe të gjithë e kuptuan se nuk mjafton të kesh emra të mëdhenj për të fituar. Rodrigo kaloi Realin përpara që në minutën e 13, por pas pushimit Muriqi barazoi në minutën e 53-të. “Nuk mund ta imagjinoj. Gjatë ndeshjes i thashë Militaos se të gjithë yjet e Realit janë shumë të shpejtë. Janë impresionues. Lojtarë të mëdhenj. Krenar që u shënova gol. U uroj fat, po ashtu edhe skuadrës sime”. “Dëshitim i madh”, shkruan e përditshmja e kryeqytetit, “Marka”, me foton e Mbapesë në kopertinë: Madridi nuk arrin më shumë se



barazimi në debutimin e tij! I njëjti titull edhe i gazetës tjetër të Madridit, “AS”, që thekson se goli i madh me kokë i Muriqit nuk i lejoi fitoren Realit! Trajneri i kampionëve të Evropës, Carlo Ancelotti, pati kritika për yjet e tij. “Vitin e kaluar edhe mund ta prananim një barazim, por këtë herë jo. Mendoj se mund të kishim luajtur shumë më mirë. Nuk dua të justifikohem aspak. Duhet të kemi mentalitet më të mirë ndaj

ndeshjeve. Na duhet më shumë ekuilibër në mbrojtje, sepse jemi ekip shumë ofensivë. Në këtë ndeshje u kuptua qartë se ku e kishim problemin”, ka deklaruar Ancelotti. Reali mbetet favorit për titullin në La Liga, për skuadrën që ka dhe duke qenë kampion në fuqi, si dhe kampion i Evropës, por gjithsesi Barcelona do ta sfidojë deri në fund, e ndoshta goli i Muriqit në fund do t’i prishë punë.

Gjithçka që duhet të dini për formatin e ri të Ligës së Kampionëve

NYON, 20 GUSHT - Futbolli është gjithmonë në zhvillim dhe kompeticioni më prestigjioz i Evropës, Liga e Kampionëve, nuk bën përjashtim nga ky zhvillim. Nga ky sezon një format i ri do të jetë në lojë pasi UEFA miratoi ndryshimet në maj të vitit 2022. Është hera e parë që nga viti 1992 që gara elitare evropiane ka pësuar një ndryshim të tillë. Presidenti i UEFA-s, Aleksander Ceferin, ka thënë se kualifikimi do të “bazohet në meritat sportive”. Faza e grupeve të Ligës së Kampionëve është vendosur aktualisht me 32 skuadra në tetë grupe me nga katër - me dy skuadrat e para nga ato grupe që kualifikohen për në 16-shen e fundit. Megjithatë, ky format do të zëvendësohet nga një tabelë e ligës ku 36 klube do të marrin pjesë në fazën e re të ligës - duke u dhënë shansin katër skuadrave të tjera për të konkurruar. Klubet nuk do të luajnë me tri ekipe dy herë, por do të përballen me tetë skuadra të ndryshme me katër ndeshje në shtëpi dhe katër



ndeshje jashtë. Për t’i përcaktuar ndeshjet, skuadrat do të renditen në katër vazo dhe secila skuadër do të hidhet në short për të luajtur me dy kundërshtarë nga secila prej këtyre vazove. Ata do të luajnë një ndeshje kundër një ekipe nga çdo vazo në shtëpi dhe një jashtë. Shorti për fazën e grupeve të këtij sezoni do të hidhet më 29 gusht në Forumin Grimaldi në Monako. Skuadrat që përfundojnë në tetëshen e parë do të kualifikohen

automatikisht në 16-shen e fundit, ndërsa ato që do të renditen nga e nënta deri në vendin e 24-t do të konkurrojnë në një “play-off” me eliminim me dy ndeshje. Kushdo që përfundon në vendin e 25-të ose më poshtë do të eliminohet dhe nuk do të hyjë në Ligën e Kampionëve. Nga 16-ta e tutje, Liga e Kampionëve do të vazhdojë ta ndjekë formatin e saj ekzistues me finalen e zhvilluar në një vend neutral.

SHKURT

Broja kërkohet nga Milani dhe Juve, Chelsea kërkon 30 milionë paundë

Sulmuesi i kombëtares kuqezi, Armando Broja, është përfolur shumë gjatë këtij afati kalimtar, por ende nuk ka asgjë zyrtare për sa i përket të ardhmes së tij. Pas një sezoni jo të mirë te Fulhami, ai u kthye te skuadra e tij, Chelsea. Mesa duket ai nuk është në planet e bluve të Londrës dhe kjo është bërë e ditur shpeshherë nga mediet e huaja. Së fundmi “The Athletic” shkruan se londinezët janë gati ta lejojnë Brojën në huazim, po vetëm me detyrim blerje përfundimtare për 30 milionë paundë. Ky është kushti i drejtuesve të klubit për ata që janë të interesuar për Brojën. Rikujtojmë që Milani dhe Juventus i pëlqejnë sulmuesin shqiptar dhe do ta shohim nëse do t’ju interesojë kushti i Chelseat.

Gundogan pensionohet nga Kombëtarja e Gjermanisë

Mesfushori i Barcelonës, Ilkay Gundogan, është pensionuar në moshën 33-vjeçare nga Kombëtarja e Gjermanisë në futboll. Lajmin e ka dhënë Gundogani të hënë në rrjetet sociale. “Pas disa javësh reflektimi. Unë kam marrë vendimin se është koha për t’i dhënë fund karrierës sime në përfaqësuesen e Gjermanisë. Mund të shikoj prapa me shumë krenari për 82 paraqitje për Gjermaninë, një numër që nuk mund ta kisha ëndërruar kurrë kur bëra debutimin tim për ekipin kombëtar në vitin 2011. Gjermania ishte nikoqire e Kampionatit Evropian të futbollit dhe si kapiten i ekipit ishte nder i madh”, ka shkruar Gundogan. 33-vjeçari ka zhvilluar 82 ndeshje me fanellën e Gjermanisë dhe ka kontribuar me 19 gola.

Henry largohet befasisht nga drejtimi i Francës

Thierry Henry është larguar nga posti i përzgjedhësit në Kombëtaren U21 të Francës për “arsye private”. Në gusht 2023, Henry mori postin e trajnerit të kombëtares U-21 të Francës dhe punësoi ish-shokun e tij të skuadrës Gael Clichy si ndihmës. “Dëshiroj ta falënderoj Federatën Franceze të Futbollit dhe presidentin e saj, Philippe Diallo, i cili më ofroi këtë mundësi të jashtëzakonshme. Fitimi i një medalje të argjendtë në Lojërat Olimpike do të mbetet një nga krenaritë më të mëdha të jetës sime. Jam jashtëzakonisht mirënjohës për këtë përvojë magjike”, ka thënë Henry, i cili ka zhvilluar karrierë të suksesshme si futbollist në klubet Monaco, Juventus, Arsenal dhe Barcelona.

Barça synon transferimin e Leaos

Barcelona pasi dështoi ta transferojë talentin spanjoll Nico Williams nga Athletic Bilbao, tash po planifikon transferimin e Rafael Leaos nga Milani. Sipas gazetës ‘Mundo Deportivo’, Leao është lojtari që Barcelona pëlqen më shumë pranë fundit të afatit kalimtar. Sulmuesi anësor portugez thuhet se vlerësohet rreth 90-100 milionë euro. Barça duhet t’i largojë disa fuqibollistë të rëndësishëm për të mbledhur paratë e nevojshme për të bërë një ofertë të përshtatshme. Opsione të tjera për Barcelonën janë edhe Federico Chiesa i Juventusit dhe Kingsley Coman i Bayern Munchen.

Mbappe kërkon 55 milionë euro nga PSG-ja

Media franceze “Le Monde” raporton se Kylian Mbappe, i cili u largua nga PSG-ja dy muaj më parë për t’iu bashkuar Real Madridit, ka kërkuar 55 milionë euro nga klubi

parisien, sepse nuk do t’i paguhej një pjesë e bonusit të nënshkrimit dhe pagave mujore për muajin prill, maj dhe qershor. Mbappe dhe enturazhi i tij iu drejtuan LFP-së

dhe UEFA-s, me ndërmjetësimin e FFF-së. Ish-kapiteni i skuadrës franceze ka vendosur ta çojë çështjen në komisionin ligjor të LFP (La Ligue de Football

Professionnel që menaxhon Ligën 1 dhe Ligën 2) dhe UEFA-s, me FFF (Federata Franceze e Futbollit) si ndërmjetëse. Objektivi është aktivizimi i një procedure ligjore

për të rikuperuar një të tretën e bonusit të nënshkrimit (36 milionë euro) dhe pagesat mujore (prill, maj dhe qershor), të parashikuara në kontratë, por të papaguara.



Rr"Motrat Qiriazhi" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com, info@kolegjobiznesi.com
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **17.07.2024**, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTAVE PËR VITIN AKADEMIK 2024/2025
01.07.2024 deri më 30.09.2024

STUDIME BACHELOR	STUDIME MASTER
1.BANKA DHE FINANCA NË BIZNES (BA) - (3 vjeçar) 2.MENAXHMENT DHE EKONOMIKS (BA) - (3 vjeçar) 3. SHKENCA KOMPJUTERIKE (BA)- (3 vjeçar)	1.MENAXHMENT DHE FINANCA – MA-(2 vjeçar) 2. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE -MA-(2 vjeçar)

Dokumentat e nevojshme për Aplikim BACHELOR
Diplomën e shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar)
Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar)
Dëftesat e viteve (klasave) - I, II, III, / X, XI, XII (Original ose të noterizuar)
Certifikatën e lindjes,
Kopja e letërnjoftimit,
Dy foto.

www.kolegjobiznesi.com,
info@kolegjobiznesi.com

Dokumentat e nevojshme për Aplikim MASTER
Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
CV
Certifikatën e lindjes
Kopjen e letërnjoftimit
Dy foto

038/045/044- 500 878
049/ 048- 500 – 878
029-230-555 : 044 131027

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Metal-in” Sh.p.k. Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për vendosjen e panelave diellor fotovoltaike me kapacitet 182 KWp, mbi objektin e fabrikës së prodhimit të rrjetave të salduara, mbajtësve kapriatë dhe shufrave të çelikut në Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 08.10.2024 në ora 09:00 në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Vëllezrit Frashëri”, në Fushë Kosovë do të organizohet debat publik nga Kompania “Metal-in” Sh.p.k. Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>
Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Metal-in” Sh.p.k. Fushë Kosovë për vendosjen e panelave diellor fotovoltaike me kapacitet 182 KWp, mbi objektin e fabrikës së prodhimit të rrjetave të salduara, mbajtësve kapriatë dhe shufrave të çelikut në Fushë Kosovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Njoftim për Debatin Publik

Duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin “Sharr Cem” Sh.p.k. Hani Elezit, fabrikë për prodhimin e çimentos, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për Dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë 20.09.2024, në ora 10:00, në hapësirat e LAB-it (Laboratori për Aktivitetet e Biznesit), Rr. Adem Jashari, Nr. 280, 71510 Hani i Elezit, do të organizohet debat publik nga operatori “Sharr Cem” Sh.p.k. Hani Elezit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ky debat publik do të mbahet për shqyrtimin e Aplikacionit për Dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Shqip Energy” Sh.P.K. me seli në Pejë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811346164 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Shqip Energy” D.O.O. od Pejë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811346164 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Shqip Energy” L.L.C. with headquarters Pejë, has come to the decision to quit its business: 811346164 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Milenium” Sh.p.k., Ferizaj në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën rekreacioni dhe pishinë në Ferizaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 08.10.2024 në ora 11:00 në shkollën SHFMU "Visar Dodani", Fshati Varosh, Komuna e Ferizajt do të organizohet debat publik nga Kompania “Milenium” Sh.p.k., Ferizaj në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82940421482?pwd=eQTsFYzOsOb4sY0NvvRx1UNrbeRfbB.1>
Password: Ze6r4e

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Milenium” Sh.p.k., Ferizaj për qendrën rekreacioni dhe pishinë në Ferizaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

